

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

*PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT*

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

***TRANSKRIPT***

***I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 05 QERSHOR 2003***

***PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 05. 06. 2003. GOD.***

---

***QERSHOR - JUNI  
2003***

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RENDI I DITËS**

- (1) Miratimi i proçesverbalit nga seanca e mëparshme
- (2) Shqyrtimi i parë i Projektligjit për planifikim hapsinor (2003/15)
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemën e ndihmës sociale (2003/16)
  4. Parashtimi i pyetjeve
  5. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 12 Qershori 2003
    - 5.1 Shqyrtimi i çështjes së privatizimit ( pritet konfirmimi )

---

Vrejtje : Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë

“Pjetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashresa të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.  
(Rregulla 21.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

**ДНЕВНИ РЕД**

1. Усвајање записника са претходне седнице
2. Прво разматрање Нацрта закона о просторном планирању (2003/15)
3. Прво разматрање Нацрта закона о шеми социјалне помочи (2003/16)
4. Постављање питања

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

5. Предлог дневног реда за пленарну седницу од 12 јуна 2003

5.1 Разматрање питања приватизације (очекује се потвђивање )

---

**Опомена : Питања упућена Влади за усмене одговоре**

"Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се очекује одговор"  
(Правило 21.2 са Привремени пословник)

**AGENDA**

1. Approval of the minutes of previous meeting
  2. First reading of the Draft Law on the Spatial Planning (2003/15)
  3. First reading of the Draft Law on the Scheme of Social Assistance (2003/16)
  4. Questions
  5. Proposal of agenda for the plenary session of 12 June 2003
- 5.1 Review of the privatization matter ( waiting for confirmation )

---

**Note: Questions to the Government for oral answer**

"Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered" (Rule 21.2 of Provisional rules of procedure)

# TRANSKRİPT

## ***I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR 05 QERSHOR 2003***

**KRYESUES I SEANCËS, AKADEMIK NEXHAT DACI, KRYETAR I  
KUVENDIT TË KOSOVËS.**

**BASHKËKRYESUES HYDAJET HYSENI, ANËTAR I KRYESISË  
SË KUVENDIT TË KOSOVËS.**

*Seanca filloi punën në orën 10,30.*

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Mirëmëngjes kolegë deputetë. Ju dëshiroj mirëseardhje në Seancën e rregullt plenare të Parlamentit të Kosovës. Po ashtu mirëseardhje ju dëshiroj ministrave dhe, në vëçanti është kënaqësi i mja e vëçantë që sot, bashkë me ne në Seancën plenare, është edhe Kryetari i Parlamentit Shtetëror të Landit Niedersachsen të Gjermanisë. Atij dhe Delegacionit Gjerman, iu dëshirojmë mirëseardhje të vëçantë.

*(Duartrokitje)*

Ndërsa, në të njëjtën kohë, kur në Kosovë ngajnjë ndërrime të mëdha pozitive dhe venimente të mira, kemi edhe raste tragjike ndaj qytetarëve të Kosovës. Vrasja e tre qytetarëve të komunitetit serb në Obiliq është një ngjarje e keqe, e shiё një humbje për krejt Kosovën, sepse qytetarët e pafajshëm kur pësojnë në këtë mënyrë, është një moment kur institucionet duhet të jenë të shqetësuara, dhe ne jemi të

*shqetësuar. Të gjitha institucionet e Kosovës dhe partitë që  
participojnë në institucionet e Kosovës e kanë gjykuar këtë akt, prandaj  
Seanca plenare i bashkëngjitet këtij rasti.*

*Dhe, më lejoni që, pas një vit mungese pune, të përshëndesim  
pjesëmarrjen përsëri të LKÇK në Parlament nëpërmjet deputetit Smajl  
Latifi. I dëshiroj mirëseardhje dhe punë të mbarë të mëtejshme,  
bashkërisht me ne.*

*Besoj se materialet e nevojshme për këtë Seancë plenare i kemi marrë  
me kohë, prandaj... Dragisha Kërstoviq, si shefi i Grupit parlamentar të  
Koalicionit "Kthimi" e ka fjalën.*

### **DRAGISHA KRSTOVIĆ:**

*Gospodine predsedniče,*

*U ime Zajednice Srba na Kosovu, u ime Srpske koalicije «Povratak» ja  
vam se zahvalujem na rečima koje ste maločas izgovorili povodom  
tragičnog ubistva troje Srba, troje nedužnih Srba u Obiliću.*

*Srbi na Kosovu se sistematski zatiru. Kao što znate, preksinoć su u  
Obiliću zverski ubijeni Slobodan i Radmila Stolić i njihov sin Ljubinko  
samo zato što su Srbi!?*

*Tražimo odgovornost za taj i sve druge zločine učinjene nad Srbima i  
posle svega, bilo bi normalno očekivati i nečije ostavke, makar one bile  
i moralni čin.*

*Mi iz Poslaničkog kluba Koalicije «Povratak» se pitamo: šta je sa  
odgovornošću predsednika Kosova; šta je sa odgovornošću premijera  
Vlade Kosova; vrha Kosovske Policijske službe; šta je sa  
odgovornostima političkih lidera?*

*Ako počinioци ovog gnusnog zločina ne otkriju, što će se najverovatnije desiti, - kuda ćemo dalje.*

*Ako se ništa ne promeni, Srbima je perspektiva na Kosovu crna i nikakva!?*

*Sa ovog mesta pozivam demokratsku Evropu i demokratsku Ameriku da zaštite Srbe na Kosovu od ubijanja i zatiranja.*

*Predsedavajućem predlažem da se predloži donošenje deklaracije o osudi ovog zločina i mislim da je izostao onaj minut čutanja, što se, inače, svuda u civilizovanim parlamentima radi. Hvala lepo.*

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

*Unë besoj që Seanca plenare i bashkëngjitet gjykimit të rastit, atë që edhe Dragisha e tha dhe ftojmë qytetarët e Kosovës që të bashkëpunojnë me organet e drejtësisë dhe të ndjekjes që rasti i këtillë dhe shumë raste të të gjithë qytetarëve të Kosovës të mëhershme të ndriçohen dhe se organet e drejtësisë do ta kenë ndihmën e Parlamentit. Nuk është që i mungon Parlamentit as kultura, as niveli i përgjegjësive, por ju kujtohet që ne kemi marrë një qëndrim që Parlamenti do të mbajë minut heshtjeje në rastet e institucioneve ose në rastet kur janë vërtetë të asaj natyre dhe, mos harroni që, pikërisht Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk ka insistuar..., pasi sipas informatave të caktuara, janë vrarë edhe udhëheqës në Kosovë – qytetarë të Kosovës.*

*Prandaj, bashkërisht i lus të gjitha grupacionet politike, formacionet në Parlament që vërtetë ta luftojmë krimin sepse vetëm ashtu n'e hapim ardhmëri dhe perspektivë për vetën tonë, për fëmijët dhe nipat tanë.*

*Pra, ju falënderoj edhe për këto vërejtje. Në qoftë se e keni për këtë çështje, jo Arsim. Po, po, urdhëro, si shef i Grupit parlamentar.*

**DRAGIŠA KRSTOVIĆ:**

*U znak protesta zbog ovog stravičnog zločina i zbog svega ovoga što se dešava i ovde i vani, ja moram da vas obavestim da će Koalicija «Povratak» napustiti današnje zasedanje.*

**(Për momentin, deputetët e Koalicionit “Kthimi” lëshojnë Seancën plenare)**

**KRYESUESI NEXHAT DACI:**

*Arsim Bajrami, shef i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.*

**ARSIM BAJRAMI:**

*Inderuari kryetar, të nderuar kolegë,*

*Në pajtim me Rregulloren e punës të Kuvendit të Kosovës, shtroj si çështje të ngutshme hapjen e debatit në Kuvendin e Kosovës për takimin e Selanikut dhe përfaqësimin e interesave të Kosovës në këtë takim.*

*Shumica e anëtarëve të këtij Kuvendi, i cili, siç e dini, është organ më i lartë në periudhën kalimtare, po informohen për këtë takim përmes mediave dhe përmes takimeve të ndryshme. Në anën tjetër, në shumë institucionë formale dhe joformale po debatohet për këtë takim dhe në një mënyrë po anashkalohet Kuvendi i Kosovës, i cili duhet patjetër të jetë i involvuar në këtë proces.*

*Po flitet se do të shkojnë përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës në këtë takim, por ata do të jenë pjesë e UNMIK-ut, pjesë e delegacionit të UNMIK-ut.*

*Meqenëse, çdo përfaqësues i Kosovës në konferencë ndërkombëtare duhet të mbrojë interesat e Kosovës dhe duhet të shkojë për mbrojtjen e interesave të Kosovës, është e nevojshme që Kuvendi i Kosovës të jetë i informuar për të gjitha çështjet.*

*Mendoj se çdo bisedë që ka të bëjë me çështjet e Kosovës, në raport me shtetet tjera, është çështje për të cilën duhet të diskutojë Kuvendi i Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka të drejtë, nuk është vetëm organ ligjvënës por është edhe organ më i lartë politik, organ që diskuton edhe çështje politike dhe kërkoj që në këtë mbledhje, ose në mbledhjen e ardhshme, të hapet debati për përfaqësimin e interesave të Kosovës në këtë takim dhe të ftohen të gjithë ata që do të marrin pjesë, të ftohen për të prezantuar qëndrimet, që do të prezantojnë edhe interesat e Kosovës që do të mbrohen.*

*Mendoj se një debat i tillë është i nevojshëm për shkak se demokracia në Kosovë është në një shkallë shumë më zhvilluar tanë. Tani kemi institucionet e Kosovës dhe mënyra se si po përgatitet ky takim është sikur të shkohet kah defaktorizimi i këtyre institacioneve të Kosovës, të cilat kanë marrë legjitimitetin e popullit. Ju falemnderit.*

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

*Para se t'i përgjigj Arsimi, deputeti i ri Smajl Latifi, meqë për herë të parë paraqitet ia jap fjalën. Urdhëroni zoti Latifi.*

### **SMAJL LATIFI:**

*Inderuari kryetar, të nderaur deputetë, e nderuar Kryesi e punës,*

*Duke ju përshëndetur, në emër të LKÇK-ës, dëshiroj të theksoj se për një kohë bukur të gjatë në Kuvendin e Kosovës, për arsyet e caktuar, i ka munguar fjala dhe zëri për bashkim kombëtar, platformë për të cilën angazhohet LKÇK si forcë politike e organizuar, realizimi i së cilës është aspiratë e të gjithë atyre që u fljuan nëpër periudha të ndryshme.*

*Duke ju përshëndetur, të nderuar deputetë, njëkohësisht dua të theksoj se çdo tendencë për të jetësuar atë që e kérkon 1244 nuk do të jetë në funksion të ruajtjes së paqës, sepse nuk është në shërbim të lirisë së Kosovës. Imponimi nga jashtë, i artikuluar në programin e UNMIK-ut, është forma më jodemokratike që praktikohet sot në Kosovë. Ne jemi të*

*thirrur për ta ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve, realitetin ekzistues, por jo duke i pranuar praktikat që na imponohen sepse rrezikojnë të ardhmen tonë për çka mendojmë se është e padëshirueshme edhe për investorët e paqës së drejtë dhe afatgjatë. Do të angazhohemi për t'i kaluar pengesat e jo për t'i tarshur ato. LKÇK do të jetë zëdhënëse e fuqishme dhe e angazhuar që bashkë me të gjitha forcat tjera politike të shprehë qartë edhe politikën e vet edhe me punë këmbëngulëse në angazhimin për ta kontestuar në një kohë të ardhme kompromisin e arritur në Këshillin e Sigurimit të OKB-ës i shkruar në 1244-shen si një rrezik për Kosovën për lirinë e popullit të saj. Të përgatitemi të gjithë për të ecur deri në mosnjohje dhe mosrrespektim të parimeve të saj, si e drejta më demokratike që duhet ta shprehim në mënyrë të organizuar sepse e duam ecjen përpara drejt lirisë sonë. Askush nga ne nuk do ta marrë guximin dhe të thotë se kornizat e Parlamentit tonë, të nderuar, i shkojnë për shtati aktualisht aspiratave të popullit tonë, por edhe të besojë se Parlamenti ynë ka mandat aktualisht për shkak të kufizimeve që ta realizojë vullnetin politik të popullit tonë, por askush nuk do të dëshironte të besonte se megjithatë deputetët kanë rënë në një gjumë dhe sikur nuk u bën përshtypje shqetësimi për lirinë e popullit, privimin nga e drejta për ta pasur atë, si dhe shkelen e të drejtave tjera.*

*Gjendja e institucioneve tona është e rëndë, skajshmërisht të cunguara, produkt i kornizave të rezolutës, e cila është e papranueshme, në radhë të parë për interesat e Kosovës dhe popullit të saj, por që duhet të jenë të papranueshme, para se gjithash, për përfaqësuesit e tij, sepse zgjedhësit na besuan mandatin për ta shpierë Kosovën drejt shkëputjes nga Serbia pushtuese e jo kah ofrimi praktik me të, siç mund të mendojë misioni i përkohshëm, pra UNMIK-u që angazhohet me vetëdije ose pa të për zbatimin e këtij dokumenti të papërshtatshëm por edhe të dëmshëm për ne.*

*Gjendja jonë ekzistuese është e rëndë. Duhet angazhimi ynë për ta ndryshuar, por jo duke kufizuar veprimin siç kërkojnë disa faktorë që nuk ia duan të mirën paqës, pra nuk mbështesin aktualisht të drejtën e patjetërsueshme për liri dhe vetëvendosje të popullit tonë.*

LKÇK konsideron se është moment shumë i rëndësishëm që të mendojmë seriozisht bashkë për ta bërë hapin praktik të kalimit në një opozitë të fuqishme, por konstruktive me UNMIK-un i cili është protagonist aktualisht i ruajtjes së një shteti që ishte pushtues në Kosovë, të cilin e luftuam edhe me armë. Ky hap do të jetë shpresë për Kosovën, për lirinë, paqën dhe demokracinë e vërtetë. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Zoti Arsim Bajrami, e besoj se Grupi, ashtu edhe e kam kuptuar, Parlamentar i PDK nuk do t'më akuzoj nesër për shkelje të procedurës. Mendoj se nuk duhet ta vëmë në votim, sepse e thatë që në një mbledhje dhe atë të ardhshme duhet ta kemi... kështu që Kryesia le ta shqyrtojë këtë dhe bashkërisht ta kemi parasysh.

Po e modifikoj procedurën në një mënyrë, sepse sipas rregullës, ju e dini që duhet të votojmë dhe nuk e shoh të arsyeshme, siç e thatë edhe ju...

Prandaj, vazhdojmë me rendin e ditës të cilin e kemi para veti dhe ky është:

**- Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar, si pikë e parë.**

Unë shpresoj se kemi një traditë të mirë dhe ata që kanë ndonjë sygjerim ose vërejtje në Procesverbal, atë ta bëjnë me shkrim dhe do të mënjanohen të gjitha lëshimet eventuale.

Meqë nuk ka vërejtje në Procesverbal të seancës së kaluar, kalojm në pikën vijuese.

**- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për planifikim hapësiror.**

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 8 maj 2003, andaj edhe janë përbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

*Shqyrtimi i sotëm do të shërbejë vetëm si shqyrtim në parim me një debat të përgjithshëm dhe më lejoni që sponzorin e këtij ligji, ta ftojë të marrë fjalën, e ky është ministri Ethem Çeku. E keni fjalën zoti ministër.*

**ETHEM ÇEKU:**

*I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,*

*Më lejoni ta paraqes ekspozeun për Draftligjin mbi planifikimin hapësinor, i cili ka bazën e objektivat e Qeverisë dhe të Ministrisë së Mjedisit d he të Planifikimit Hapësinor për realizimin e detyrave nga fusha legislative.*

*Ky Draftligji, përnga përbajtja, krahas Ligjit për mjedis më parë të miratuar nga ky Kuvend, në rendin juridik të Kosovës përfshihet me akte normative juridike të karakterit sistemor.*

*Planifikimi hapësinor dhe urbanistik, paraqet njhëren nga segmentet më të rëndësishme të perspektivës zhvillimore në botën bashkëkohore. Ai, gjithashtu, është proces kompleks ku reflektojnë ndryshimet demografike, ekonomike, sociologjike, teknologjike e tjera, që ndodhin në shoqëri dhe manifestohen në hapësirë.*

*Shkalla e ulët e zhvillimit shoqëror-ekonomik ka rezultuar negativisht në planifikimin hapësinor dhe urban të deritashëm në Kosovë. Prandaj, janë të domosdoshme përpjekjet për shpejtimin e procesit të planifikimit hapësinor dhe urban.*

*Planifikimi hapësinor dhe urban i organizuar, i orientuar drejt, i sinkronizuar dhe kontrolluar mundëson eliminimin e devijimeve dhe dobësive në këtë plan dhe krijon kushte të përgjithshme organizative për arritjen e rezultateve dhe mundësive të realizimit të prioriteteve afatgjata të zhvillimit.*

*Një planifikim i tillë hapësinor dhe urban do të mundësojë transformimin e shpejtë të gjitha strukturave shoqërore-ekonomike dhe demografike në Kosovë.*

*Të nderuar deputetë,*

*Më lejoni që me këtë rast t'i them edhe disa fjalë për qëllimet themelore të planifikimit hapësinor dhe urban në Kosovë dhe perspektivat e zhvillimit të saj.*

*Qëllimet themelore të planifikimit hapësinor dhe urban në Kosovë janë në përputhshmëri me qëllimet e shteteve në transicion dhe shteteve tjera të Evropës, ku vlenë të theksohen këto tri elemente kryesore:*

- politika e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik duhet t'i kontribuojë konkurrencës dhe efikasitetit;
- të ndihmohet kohezioni ekonomik dhe social në Kosovë;
- të sigurohet konservimi i trashigimisë natyrore-kulturore; mbrojtjen mjedisore – parakushte këto të një zhvillimi të mirëfilltë.

*Ndërkaq, detyra kryesore të përmirësimit të strukturave hapësireore janë:*

- Krijimi i raporteve të reja në relacionin fshat-qytet ku do të përfshihen sigurimi i zhvillimit gjithpërfshirës;

- Trajtimi i dallimeve rajonale, në kuadër të politikës gjithpërfshirëse me koncentrim në zona me ngecje zhvillimore apo në ato ku ka kritë serioze strukturore por pa rrezikuar zhvillimin e rajonit;
- Zbutja e problemeve të krijuara në kufij si pasojë e hapjes së numrit më të madh të kalimeve kufitare me ç'rast do të intensifikohet bashkëpunimi ndërkufitar me përmirësimin kualitativ të rrjetit rrugor;
- Zgjerimi i strukturës ekonomike dhe strukturës së të punësuarve në fshat, në fusha të monokulturës bujqësore dhe të qyteteve me vetëm një veprimtari prodhuese, me promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me shfrytëzimin e resurseve vendore dhe me kombinimin e masave të ndryshme të politikës ekonomike;
- Sigurimi i informatave nga të gjitha fushat në alukim dhe profilimi i drejtë i institucioneve arsimore, kulturore dhe hulumtuese, me ndërlidjen e këtyre institucioneve dhe shfrytëzimin e teknologjive informative moderrne;

*Planifikimi hapësinor dhe urban në Kosovë është zhvilluar në kushte të sistemit të centralizuar të planifikimit dhe në kushte të mungesës së një ekonomie të tregut.*

*Planifikimi hapësiror dhe urban duhet përshtatur kushteve të tregut, të paluajtshmërite dhe të pronës, duke marrë parasysh zhvillimet e sypozuara ekonomike sociale.*

*Planifikimi hapësinor dhe urban duhet të ecë krahas kërkcesave të reja të subencionimit, krahas kompetencave të varura në mes pushtetit dhe atij lokal, krahas proceseve të reja të parcipimit në planifikim dhe zhvillim.*

*Të nderuar deputetë,*

*Më lejoni t'i theksoj disa veçanti lidhur me Draftligjin e propozuar.*

*Janë bërë të gjitha përpjekjet që materia e planifikimit hapësinor, me ligjin e ri të rregullohet në mënyrë gjithpërfshtirëse me qëllim që përvet harmonizimit me akte më të larta të Kosovës të sigurojnë një bazë bashkëkohore normativo-juridike për planifikim afatgjatë të hapësirës dhe të vendbanimeve në Kosovë, që do të jenë në përputhje me trendet më të reja të planifikimit hapësinor në Evropë.*

*Qëllimi i planifikimit dhe i rregullimit të hapësirës së Kosovës parashihet të jetë në të vërtetë realizimi i politikës dhe i strategjisë së zhvillimit ekonomik, demografik, social, teknologjik, kulturor dhe ekologjik të Kosovës. Për herë të parë përcaktohen qëllimet, të cilat duhet arritur në përgjithësi me planifikimin hapësinor, por njëkohësisht edhe parimet të cilat duhet të jenë të njohura edhe për të gjithë shfrytëzuesit.*

*Planifikimi hapësinor dhe urbanistik, me Draftligjin e ri, dobësojnë ndryshime rrënjosore. Nga një planifikim statik do të bëhet transformimi në planifikimin zhvillimor dhe dinamik. Ligji i ri krijon kushte që për një plan të sigurohen të dhënat dhe informatat e sakta për shfrytëzimin e tokës sipas ngastrave, komplekseve, zonave. Pastaj sigurimi i të dhënavëve mbi shfrytëzimin racional të tokës, nevoja për rikonstruimin, rehabilitimin, rivitalizimin e tjera.*

*Me këtë Draftligj, në procesin e nxjerrjes së akteve të planit, parashihen dhe sigurohen procedura të detyrimit dhe mundësitet e pjesëmarrjes së të gjithë shfrytëzuesve të hapësirës, të persoanve juridik, të qytetarëve dhe të shfrytëzuesve tjera.*

*Sikur në vendet me ekonomi të tregut, me këtë Draftligj, janë caktuar titullarët, përgjegjësit, kompetencat dhe subjektet tjera për kryerjen e punëve të planifikimit hapësinor si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.*

*Draftligji konsiderojmë se është në përputhshmëri me ligjet më të reja dhe bashkëkohore të disa vendeve në transicion dhe si i tillë do të lehtësojë përkatësisht mundësojë zbatimin e politikës në rregullimin*

dhe shfrytëzimin e hapësirës në të gjitha nivelet si dhe zvogëlimin e disparitetit të madh të palejueshëm të hapësirës dhe koncentrimin e ekonomisë, të shërbimeve publike dhe të popullsisë në qendra kryesore.

Të nderuar deputetë,

Për t'u zbatuar baza e plotë juridike për zgjidhjen e çështjeve dhe për t'i arritur synimet e përcaktuara në fushën e planifikimit hapësinor, hapi i parë duhet nisur nga ky Kuvend, i cili, me miratimin e këtij Draftligji, pos tjerash, do të mundësojë edhe mbështetjen ligjore për fillimin e hartimit të planit hapësinor të Kosovës që, jo rastësish, ka ataributin e kushtetutës së dytë. Ju falemnderit për vëmendje.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ministër, ju falemnderit për ffjalë përbajtësore, të thuktë dhe inspiruese.

Hap debatin në parim.

Ftoj deputetin Naim Maloku të marrë ffjalën dhe le të përgatitet deputetja Sala Ahmetaj.

### **NAIM MALOKU:**

I nderuar zoti kryetar, të nderuar ministra, zonja dhe zotërinj, të nderuar deputetë,

Komisioni parlamentar për mjedis dhe planifikim hapësinor, me datë 28.05. 2003 ka shqyrtuar në parim Projektligjin i cili sot shqyrtohet në parim. Të ftuar në atë shqyrtim kanë qenë edhe përfaqësuesit e Ministrisë për Planifikim Hapësinor dhe Mjedis, të cilët kanë bërë sqarimet shtesë në pyetjet që janë parashtruar nga anëtarët e Komisionit parlamentar.

Të nderuar deputetë,

*Pas luftës, në fazën e rindërtimit të Kosovës, por edhe më parë, është evidente që Kosova, në të gjitha qytetet dhe vendbanimet e saja ka përjetuar shtirje horizontale të pakontrolluar dhe jashtë planeve urbanistike. Për të bërë rregullimin hapësinor të Kosovës konform standardeve të shteteve të zhvilluara demokratike, do të duhej ndërhyrje esenciale në ndërtimet dhe rindërtimet që janë bërë në të gjitha vendbanimet dhe qytetet e Kosovës.*

*Projektligji i propozuar paraqet një bazë ligue për ndërhyrje në rregullimin hapësinor të Kosovës. Ky Projektligj nuk do t'i rregullojë të gjitha çështjet dhe problemet e grumbulluara vite dhe dekada me radhë në Kosovë. Për këtë do të kërkohet ndërhyrje esenciale, do të kërkohet një angazhim i vazhdueshëm nga institucionet më të larta qendrore të Kosovës deri në nivelet më të ulëta. Pra, do të kërkohet një ndërhyrje e cila mund të shkaktojë edhe tronditje sociale, në qoftë se marrim parasysh kërkësen dhe angazhimin që në këtë sferë, pra të rregullimit hapësinor të Kosovës, t'i përvpejtojmë hapat në mënyrë që t'i arrijmë standardet që Kosova të integrohet në atë bashkësi, në Bashkësinë Evropiane ku është synim i qytetarëve të Kosovës.*

*Ligji, posaçrisht nenet 23.5, 23.6, pastaj nenit 24.2 dhe 26.2 kërkojnë sqarime dhe përmirësimë shtesë për shkak se në vetëpërbajtjen e tyre shprehin kontradikta dhe janë kontradiktore, këto i kemi shqyrtuar edhe në mbledhjen në fjalë, pra kur është shqyrtuar ky ligj në parim dhe kemi kërkaur referenca dhe sqarime shtesë nga Ministria e cila ka propozuar edhe këtë ligj.*

*Në emër të Komisionit parlamentar për mjedis dhe planifikimi hapësinor, të nderuar deputetë, ju ftoj që ky ligj të përkrahet në parim. Më lejoni të theksoj përkrahjen edhe mbështetjen në këtë ligj edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Ju falemnderit.*

## **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

*Ju falemnderit. Sala Ahmetaj, le të përgatitet deputeti Haki Shatri.*

## **SALA AHMETAJ:**

*I nderuar kryetar, të nderuar deputetë dhe të nderuar ministrat,*

*Kosova po ballafaqohet me shumë të këqia. Një ndër to është edhe mosplanifikimi hapësinor që po e lë Kosovën dhe fshatin pa tokë të bukës, kurse qytetet, e sidomos Prishtinën, që lënë përshtypje të një fantazme të çimentuar, e cila ta zë frymën dhe të ngulfatë. Prandaj, nxjerra e këtij ligji, është ndër çështjet më parësore që shtrohet para nesh, sepse shpresojmë dhe duam të besojmë se me të do të shmanget shëmtitë dhe shpërfillje të shumta që po përcjellin planifikimin hapësinor të Kosovës. Dhe, arritja e zgjidhjes së problemeve dhe vështirësive të shumta, duhet të jenë synim i të gjithëve – edhe mediave, edhe shkollës, edhe Qeverisë me qëllim që populli të vetëdijësohet përrëndësinë e planifikimit hapësiror.*

*Vetë zhdukja e mbi 20 mijë hektarëve të tokës bujqësore për vetëm dhjetë vjet dhe vetëdija tejet e ulët e njerëzve për planifikim edhe në fshat e edhe në qytet ka shndërruar Kosovën në një lagje të pakuptimtë dhe të çoroditur. Anarkia po shkatërron tokat bujqësore, prandaj Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të bëjë rivlerësimin e ndërtimeve dhe të kërkojë që sa më shpejtë që është e mundur komunat të kenë plane urbane edhe përfshatra, sepse sipas disa të dhënavëve vetëm 12 komuna kanë plan urban përfshatra dhe atë për 142 fshatra prej rreth 1.400 sa janë tërësisht.*

*Ligjin që po e shqyrtojmë dhe që do ta miratojmë sot e kam lexuar me vëmendje. Natyrisht, ne do të flasim më shumë përmangësitë, me qëllim që ai të bëhet më i përkryer. Disa nene kanë shumë fjali të gjata dhe kjo nuk do të duhej të ishte veçori e ligjit, sepse ato duken sikur një ese e mirë ose sikur konkluza që nxirren pas ndonjë mbledhjeje a debati. Mund t'i shihni edhe ju vetë. Pastaj, ligji duhet të ketë fjali të*

*shkurtëra dhe të qarta. Mandej, shumë gjëra janë thënë në mënyrë përgjithësuese, pa saktësime dhe pa kritere të precizuara. Për shembull, neni 3; pastaj neni 5.2 dhe 11.3. Mund t'i shihni dhe, sipas nesh, ligji nuk bën promovimin ose propagandimin. Ato punë i bën shkolla, media, ministria nëpër seminare të ndryshme e tjera, kurse ligji duhet të saktësojë, të qartësojë dhe të normojë se ç'është e lejueshme dhe çfarë nuk është e lejueshme. Ligji, domethënë, nuk do të duhej të dukej si një platformë politike ose si një plan nacional. Ai ndoshta do të duhej të mbështetet në një plan të tillë nacional, sepse ai më pak edukon, ai më shumë duhet të krijojë dhe të zbatojë norma.*

*Në disa raste, duken të paqarta marrëdhëniet në mes të nivelit të parë dhe nivelit të dytë. Kujtojmë se nivelit të dytë i janë lënë shumë mundësi për shmangje nga parimi. Administratës lokale nuk do të duhej t'i lejohej një mundësi e tillë, Shihni ninen 24.1, sepse fatkeqësisht ne nuk kemi arritur ende vetëdijen dhe përkushtimin e ndërgjegjen, ta zëmë, si të sllovenit ose të sudezit, për ruajtjen e ambientit dhe të hapësirës. Qytetarit të Kosovës i është zvogëluar tmerrsisht shumë hapësira dhe i është ndotur ambienti në masë dhe shkallë shumë të lartë. Prandaj, me qëllim që ta ndërrojmë këtë gjendje, ligji do të duhej të ishte më i ashper dhe të parashihet dënimë më të larta për ndotësit dhe tjetërsuesit e hapësirës.*

*Pastaj, afatet kohore të parapara për përgatitjen e planeve hapësirore dhe urbane për 18 muaj, domethënë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, na duken të paarsyeshme. Afati do të duhej të parashihej për një periudhë kohore shumë më të shkurtër, sepse deri atëherë do të gllabërohet ende hapësira e gjelbëruar dhe toka pjellore. Neni numër 32 është.*

*Pastaj, neni 7.3 duke ti paqartë dhe konfuz. Ka aty-këtu edhe gabime logjike, për shembull neni 5.1 nën c), në një vend shkruan "për përparimin e kushteve të hapësirës" ... domethënë për përparimin e planeve hapësinore, e tjera. Nuk do të ndalem në tjerat. Pastaj neni 5.2 h) dhe 5.3 i cili ka një konfuzitet të lartë dhe ffali të shpërbëra. Domethënë, do të duhej të riformulohej.*

Dhe, në fund, kam një përgëzim. Në rast të ndonjë paqartësie, fatmirësish me këtë ligj: varianti shqip quhet parësor. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit shumë. Para se t'ia jap fjalën folësit tjetër, i lus të tjerët të rrespekojnë rregulloren. Ata që kanë të shkruar - një faqe, ose maksimum 5 minuta. Unë kisha rrespekt dhe nuk bëra vërejtje në dy rastet e mëparshme. Është ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar, nëse ka nevojë, urdhëroni Arsim Bajrami. Ju lutem, po s'e kërkuat fjalën, unë s'e kam obligim t'i ftojë.

### **ARSIM BAJRAMI:**

Të falemnderit. Në të vërtetë, me procedurën e leximit të parë, është paraparë që pas komisioneve kryesore dhe komisioneve funksionale, qëndrime t'i shprehin shefat e grupeve parlamentare dhe kjo duhet të rrespektohet. Vetëm ata kur nuk donë me folë, nuk thirren, përndryshe ne edhe kemi patur këtë procedurë. Ju ju kujtohen ligjet e mëparshme, gjithmonë shefat e grupeve parlamentare kanë dalë dhe shprehë qëndrimet politike rreth ligjit.

Përvetësoj se propozuesin e ligjit dhe e përgëzoj për një draft të mirë të ligjit, një ligji sistemor do të thoja, i cili pretendon të rregullojë një materie shumë të rëndësishme: materien e planifikimit hapësinor. Po ashtu, e përgëzoj për mbështetjen e standardeve ndërkombëtare dhe besoj se me miratimin e këtij ligji do të plotësohet një vakum i nevojshëm, do të kemi një rregullim të planifikimit hapësinor çfarë ka nevojë Kosova duke patur përbazë faktin se në periudhën e pasluftës kemi edhe një kaos sa i përket planifikimit hapësinor dhe një shfrytëzim të paplanifikuar të tokës hapësinore.

Mendoj se ligji është bërë mirë. Struktura dhe organika e ligjit është standarde dhe i përfshin të gjitha materiet që duhet t'i përmbarë ky ligj. Ajo që për leximin e parë do t'i sygjeroja sponzorizuesit të ligjit ta ketë parasysh në leximin e dytë dhe tretë – do t'i sygjeroja më tepër disa

*çështje metodologjike të ligjit. Çështja e parë është ajo çështja që po na përcjellë te të gjitha draftet e ligjit, është fakti se në disa ligje po kemi materie ligjore dhe disa çështje që s'janë materie legislative. Për shembull, merreni nenin 2, që është nen i gjatë në këtë ligj dhe ku shpjegojen shprehjet apo nacionet. Unë e dij se kjo praktikë legislative është futë në përdorim në Kosovë nga UNMIK-u por nuk është një praktikë e nevojshme meqenëse shprehjet dhe nacionet mund të shpjegojen në një shtojcë apo aneks të ligjit. Nuk kemi nevojë çdo ligj ta ngarkojmë gjithmonë duke i shpjeguar se çka janë nacionet që i përdorë ligji, por unë e kuptoj se kjo praktikë ligjvënëse është aplikuar me rregullore të UNMIK-ut, akoma para se të konstituohet ky Parlament.*

*Ajo që është shumë e rëndësishme në këtë ligj, dhe që është shumë pozitive, është – Dispozitat kalimtare. Më duket se te asnjë ligj nuk kemi patur më të kompletuara dispozitat kalimtare dhe Ministria ka paraparë në mënyrë detajuese se si do të bëhet transicioni në implementimin e këtij ligji. Mendoj se kjo praktikë do t'u shërbuje edhe ministriive tjera që me dispozitat kalimtare t'i rregullojnë të gjitha çështjet e implementimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit. Pra, ajo periudha e tarnsicioinit kur fillon ligji plotësisht të zbatohet. Në këtë drejtim, Komisioni për çështje legislative dhe kushtetuese, në një mbledhje të ardhshme, do t'i japë të gjitha ministriive dhe komisioneve një skemë të një strukture të ligjit, në mënyrë që, siç kemi thënë edhe në mbledhjen e kaluar, ligjet e Kosovës të jenë sa më shumë unike, të krijojmë një sistem homogjen juridik. Nëse vazhdojmë kështu do të krijojmë shumë praktika dhe shumë doktrina juridike këtu çfarë nuk i duhen Kosovës.*

*Pra, edhe një herë, në emër të Grupit Parlamentar, jap mbështetje parimore këtij ligji dhe shpresoj se në debatin e mëtejshëm profesional ky ligj do të plotësohet me plotësimet e nevojshme. Ju falemnderit.*

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

*Ju falemnderit. Zoti Haki Shatri, le të bëhet gati Ramadan Kelmendi.*

## **HAKI SHATRI:**

Të falemnderit zoti kryetar. Të nderuar kolegë deputetë, të nderuar ministra,

Nuk dola këtu të flas për rëndësinë e ligjit dhe rëndësinë e planit hapësinor sepse më duket është e tepërt, të them ashtu, për këtë rast dhe për këtë ambient.

Dola t'i them vetëm dy çështje shkurtazi e që i përgjigjen, mendoj, kësaj faze të procedimit të këtij ligji.

E para: Për shkak të vetëdijës për rëndësinë shumë të lartë dhe shumë të madhe që ka plani hapësinor, mendoj se ky plan është komplementar me strategjinë e zhvillimit global ekonomik dhe mendoj se Qeveria duhet të mendojë paralelisht edhe me hartimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik, sepse këto shkojnë si një tërësi. Dhe, m'u për shkak të rëndësisë dhe peshës së madhe që ka plani hapësinor në zhvillimin e gjithmbarshëm të një shoqërie, mendoj se paraprakisht duhet të mendohet që të hartohet edhe një dokument i cili do të shkonte së bashku me planin hapësinor, që do të ishte një analizë e gjendjes, e mundësive dhe qëllimeve të zhvillimit hapësinor. Dhe, në gjithë këtë sferë të analizës dhe të hartimit të planit hapësinor, duke patur parasysh se përbërja e tij është multidisiplinare, mendoj se duhet të gjendet forma ligjore që në hartimin e këtij plani të përfshihen të gjitha institucionet shtetërore dhe joshtetërore profesionale, gjë që kjo pjesë mungon në këtë ligj.

Dhe, çështja tjetër, që dua ta them si konkrete në këtë ligj, e për këtë fazë mendoj se duhet të kihen parasysh – është se, në disa vende, më duket, është përzierë koncepti i planit hapësinor dhe planit urbanistik. Këtë duhet sqaruar për ata që nuk e kanë shumë të qartë, për periudhat e mëvonshme.

Një çështje, që më duket do të jetë si pengesë më vonë, është plani i zhvillimit të përgjithshëm të komunave dhe mbetet obligim sipas dispozitave të këtij ligji t'i paraqitet Ministrisë së Ambientit. Nuk e dij

*sa do të ketë kapacitet dhe mundësi kjo ministri t'i absorbojë dhe harmonizojë planet e zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik dhe ndoshta do të duhet këtu paraparë që, edhe ministritë që kanë resor zhvillimin ekonomik, të parashihen në këtë projektligj.*

*Dhe, mendoj është edhe një çështje te afatet. Aktet përcjellëse, që duhet të nxirren për zbatimin e këtij ligji, parashohin afatin për një vit prej datës së miratimit të ligjit, kurse nxjerrja e planeve - një vit e gjysmë. Po mbetet më shumë kohë për nxjerrje të akteve përcjellëse sesa për hartimin e vet planeve urbanistike dhe hapësinore. Ndoshta këtë termin duhet harmonizuar pak më përshtatshëm për hartuesit e planeve.*

*Dhe, krejt në fund, meqenëse kjo duhet të bëhet në një periudhë kohore të caktuar dhe kërkon angazhim e mjete të caktaura, Ministria duhet të dalë me një vlerësim të mjeteve të nevojshme për hartimin e planit, sepse këto mjetet sigurisht për planin e gjithmbarshëm hapësinor duhet t'i sigurojë buxheti i Kosovës, kurse ato për zhvillimin e komunave, dihet - komunat.*

*Për fund, mendoj se duhet për këtë fazë ta përkrahim dhe të shkojë në procedurë të mëtejshme. Ju falemnderit.*

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

*Ju falemnderit. Ramadan Kelmendi dhe le të bëhet gati Zyrije Maloku.*

### **RAMADAN KELMENDI:**

*I nderuar kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra të rrespektuar,*

*Kosova deri më tani asnjëherë nuk pati një projekt të vërtetë mbi planifikimin nacional hapësinor me interes të përgjithshëm për qytetarët e saj. Shfrytëzimi i hapësirës gjeografike në Kosovë u*

*planifikua dhe shfrytëzua për interesat parciiale të tjerëve, jo përsë këtë nuk e dinin qytetarët e saj, por për faktin se ata asnjëherë nuk patën mundësi që të vendosin për këtë me ligjet e veta dhe për nevojat e veta.*

*Andaj, Grupi Parlamentar i LDK vlerëson se është e domosdoshme që ta kemi ligjin mbi planifikimin hapësinor për ruajtjen e sipërsaqeve hapësinore gjeografike dhe për mbrojtjen e ambientit dhe mjedisit njerëzor.*

*Unë do t'i paraqes disa sygjerime për Ministrinë gjegjëse dhe Komisionin gjegjës.*

*Ky ligj duhet të përcaktojë obligimet e komunave që ta bëjnë planifikimin hapësinor në territorin e vet dhe në veçanti të përcaktojë zonat urbane, zonat periferike urbane dhe zonat fshatare dhe nëse këtë nuk e bën brenda afateve të përcaktuara, duhet paraparë një dispozitë që do të parashehë masën ndëshkimore. Të obligohen komunat që ministrisë gjegjëse, brenda një afati, po e zëmë, gjashtëmujorë, t'ia dorëzojnë planifikimin hapësinor duke u mbështetur në standarde bashkëkohore urbane dhe duke përcaktuar zonat mbrojtëse të ambientit hapësinor.*

*Në nenin 3, vlerësoj, ku janë paraparë parimet për planifikimin hapësinor, mungon një parim me rëndësi dhe ai është: të përfshihet planifikimi mbi parimin e profesionalizmit dhe mbështetjes shkencore, dhe nëse nuk inkorporohet mbetet hapësirë e planifikimit joadekuat.*

*Për të arritur qëllimet e duhura të planifikimit hapësinor, Ministria, jo “duhet” por të obligohet të formojë institucione përkatëse profesionale për planifikim hapësinor me dëshire më të madhe që ta ruajë dhe së paku këtë pasuri hapësinore që ka mbetur ende pa u degraduar.*

*Me nenin 3, pika 4, vlerësoj se janë paraparë kompetenca të mëdha, them kështu, të larta për Ministrinë që ajo t'i merrë programet, kushtet e dhënes së provimit profesional si dhe lecitimin për ekspertët apo institucionet që do të bëjnë planifikimin hapësinor. Kjo materie patjetër*

*duhet rregulluar me ligj ashtu siç është rregulluar edhe për disa sfera tjera siç është për jurisprudencë, mjekësi, profesionalizëm e tjera.*

*Propozimligji, po ashtu, nuk përcakton zgjidhjen e rastit të konflikteve në mës i interesave në rast të planifikimit hapësinor në nivel komunal dhe nivel qendror të Kosovës dhe në këto raste nuk përcakton as arbitrazhë e as kompetencë lëndore territoriale për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve eventuale.*

*Vlerësoj se nuk është e drejtë dhënia e mundësisë komunave që në çdo vit, në çdo pesë vjet, kërkoj falje, të ndryshohet planifikimi i rregullave urbane se kjo do të shkaktonte probleme të mëdha, varësisht nga ndërrimet e qeverive komunale që bëhen si pasojë e zgjedhjeve shumpartiake dhe rezultateve zgjedhore.*

*Vlerësoj se dhënia në shqyrtim publik të planifikimit hapësinor është një e drejtë që duhet përkrahur dhe rrespektuar, por jo vetëm formalisht, nga se këtu nuk është paraparë si do të miratohen vërejtjet, plotësimet, ndryshimet dhe sygjerimet e qytetarëve ose cili është efekti i mospranimit të një planifikimi hapësinor në nivel qendror apo në nivel lokal nga qytetarët dhe se a do të merret parasysh interesi i qytetarëve në raport me parimet e ekspertëve të paraparë në këtë drejtim.*

*Në Propozim ligj vend meritor duhet zënë patjetër edhe masa ndëshkimore për ata që nuk e rrespektojnë. Vlerësoj se Ministria dhe Komisioni funksional i Kuvendit do t'i marrin parasysh këto vërejtje. Përndryshe, unë përkrah që të gjithë ata që janë për miratimin e parë dhe të plotësuar me amendamentet e ardhshme të Propozimligjit mbi planifikimin hapësiror. Ju falemnderit.*

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

*Ju falemnderit shumë Ramadan për rrespektim të kohës. Zyrije Maloku, le të bëhet gati Blerim Baruti.*

## **ZYHRIJE MALOKU:**

*Inderuar zoti kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë,*

*Unë do të provoj të jam e shkurtër, pra t'i përbahem Rregullores së punës së Kuvendit dhe mendoj se do ta kryej shumë shpejt.*

*Të gjitha ligjet që janë aprovuar dhe ato që janë në procedurë, janë të rëndësishme dhe të domosdoshme për Kosovën. Projektligji për planifikimin hapësinor është i një rëndësie të veçantë dhe mendoj se jemi vonuar në nxjerrjen e këtij ligji, prandaj duhet të kontribuojmë që ky ligj të aprovohet sa më parë.*

*Është momenti dhe koha që të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë që me një qasje profesionale të hartohen edhe shumë ligje tjera, të cilat do ta ndihmojnë Kosovën për një zhvillim sa më të shpejtë dhe dinamik.*

*Në ditët e sotme në Kosovë, problemi i planifikimit hapësinor është gjithnjë e më i definuar si çështje globale. Mund të hemi se numri i mbindërtimeve dhe ndërtimeve të egra është vazhdimisht duke u rritur dhe lirisht mund të themi se mbijnë shtëpiat brenda natës si, në thojza, "kërpurdhat pas shiut". Jemi duke pa haptas një shkatërrim total të tokave pjellore, sepse shumë fusha të pëlleshme prej të cilave është siguruar një sasi e madhe e drithërave dhe kulturave tjera bujqësore sot ato toka janë mbuluar me ndërtesa të ndryshme shoqërore dhe private duke krijuar lagje periferike të qyteteve të ndryshme. Andaj, miratimi i ligjit për planifikim hapësiror është çështje me prioritet të veçantë. Ky prioritet qëndron në faktin se me miratimin e ligjit do të hartohen rregulla me të cilat do të ndalojen të gjitha veprimet të cilat i shkaktojnë dëm territorit të Kosovës.*

*Ligjin e kam lexuar me vëmendje dhe kam disa vërejtje, të cilat nuk do t'i përmend sot këtu, por do t'ia dorëzoj Komisionit gjegjës me shkrim.*

*Një çështje që mua më duket se është e një rëndësie të veçantë, që është cekur në Projektligj, është procesi i punës së hartimit të planit hapësinor për Kosovën në përgjithësi dhe po ashtu edhe plani*

*zhvillimor për komuna. Sipas këtij ligji, asnë plan zhvillimor, qoftë ai qendror apo komunal, nuk do të miratohet pa iu oforuar publikut nëpërmes bazës së të dhënave të planifikimit hapësinor të botuar në gazetën zyrtare ose përmes mjeteve të informimit publik, në kohë të duhur, para mbajtjes së takimeve apo konsultimeve. Po ashtu, është shumë e qëlluar pjesëmarrja pa dallim gjinie dhe komuniteti.*

*Dhe, në fund, mendoj se ky ligj, pas miratimit nga Kuvendi, duhet të hyjë menjëherë në fuqi, nëse duam që Kosova të ndërtohet ashtu si duhet, të zbukurohet dhe të ketë mundësi edhe të krahasohet me shtetet e Perëndimit. Ju falemnderit.*

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

*Ju falemnderit shumë. Blerim Baruti, le të bëhet gati deputeti Hasan Meta. Si duket heq dorë, shummirë, më pëlqeu kjo...*

### **BLERIM BARUTI:**

*I nderuar kryetar, Kryesi e punës, ministra të rrespektuar, kolegë të nderuar deputetë,*

*Ju lutem më lejoni t'i paraqes pikëpamjet e mia rrëth shqyrtimit të parë të Projektligjit për planifikimin hapësinor. Në vazhdën e begatimit të kornizës ligjvënëse kosovare, sot po debatojmë për një ligj të një rëndësie të veçantë. Pas periudhës katërvjeçare, do të mundësohet që në kuadër të sistemimit ligjor, t'i qasemi një inçizimi të gjendes faktike të planifikimit hapësinor, megjithë faktin se deri më tanë, sipas njoftimeve Ministria ka arritur t'i identifikojë rrëth 15 mijë ndërtime ilegale, me vend e pavend.*

*Ky plan i ri hapësinor, në kushtet dhe rrethanat aktuale, kërkon sakrificë dhe angazhim të madh. Me anë të këtij ligji, do të sigurohet trajtim i njëjtë për të gjitha format e pronësisë dhe për të gjithë qytetarët karshi formave legale të pronësisë duke i harmonizuar*

*interesat publike dhe private të shoqërisë kosovare me çka do të afrohet mundësia e ngritjes së kualitetit të jetës me një shfrytëzim racional të hapësirës.*

*Ligji për planifikimin hapësinor do të segmentohet në dy nivele: në atë qenderor dhe komunal. Niveli qendror do të orientohet në planin e përgjithshëm hapësinor dhe në planin hapësinor për zonat e veçanta. Ndërsa, niveli komunal do të orientohet në planin zhvillimor të komunave, planin zhvillimor urban, planin zhvillimor rregullativ-urban. Niveli qendror do t'i ofrojë këshillave asistencë niveleve komunale. Sygjeroj që të formohet instituti i planifikimit hapësiror në kuadër të ministrisë me tendencë që pas një periudhe kohore të pavarësohet, ku në këtë institucion do të kyçeshin ekspertët e nevojshëm të kësaj lëmie, si arçitektë, ndërtimtarë, ekologë, juristë e ekspertë të tjera.*

*Ligji në fjalë, është bazik dhe do të jetë shtytës për përhapjen e procedurës normative edhe për 12 akte tjera nënligjore, të parapara që do ta rregullojnë zbatueshmërinë e këtij ligji.*

*Ligji është i harmonizuar me standarde ndërkombëtare. Në përpilimin e tij, kanë marrë pjesë ekspertë vendor, si nga Ministria dhe jashtë ministrisë e po ashtu edhe ekspertë ndërkombëtar të cilët me këtë rast i përuroj në sajimin e këtij ligji.*

*Në veçanti përshëndes kontributin e madh e të pakursyeshëm të zotit Riçard Gejmard.*

*Duke tentuar që të ndikojë sa më pozitivisht dhe duke mos zbehur në asnjë masë punën e angazhimin e deritanishëm, sygjeroj që në periudhën deri në shqyrtimin e dytë të Projektligjit, ky ligj të plotësohet dhe begatohet edhe më tej. Ju falemnderit.*

## **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

*Exhlale Salihu, le të bëhet gati Esat Dauti, dhe mos u inspironi ju të tjerët tepër sepse vazhdimisht po paraqiteni duke i dëgjuar tjerët.*

### **EXHLALE SALIHU:**

*I nderuar kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,*

*Përshëndes ligjin për planifikim hapësiror si ligj mjaft i rëndësishëm për çdo kohë, meqë është shenj civilizimi i një shoqërie, treve apo shteti, e sidomos në këtë kohë kur po bëhen ndërtime të vrullshme, që në të shumtën e rasteve edhe pa iu përbajtur planit urbanistik.*

*Ky ligj është përpiluar nga ekipi profesionalist, në përbërjen e të cilin ka edhe arkitektë me traditë të gjatë familjare. Megjithatë, duke u nisur nga fakti se nuk ka kurgjë të përsosur, do t'i jap nja dy propozime e plotësime për mos t'ju marrë kohën e çmuar.*

*Në nenin 2, ku bëhet fjalë për përkufizime, te toka ndërtimore, në faqën 2, thuhet se "toka ndërtimore është toka në të cilën janë ndërtuar objektet" dhe vazhdon më tej. Unë mendoj kështu: cilat objekte? Për cilat objekte bëhet fjalë? Duhet precizuar – për objekte shoqërore apo për objekte private. Këto kanë qenë të precizuara që në kohën romake shummirë dhe tash kemi një konglomerat të madh ku janë përzier objektet shoqërore dhe private. Dhe, çka është më keq, në vendin e shumë objekteve shoqërore, po ndërtohen objekte private duke dëmtuar rrëthin që është në kundërshtim me pikën vijuese – linjen e rregullimit, ku nënkuptohet vija kufizuese në mes të ngastrës së ndërtimit dhe të të drejtës së shfrytëzimit të rrugës publike, ku në këto raste po shfrytëzohet edhe rruga publike.*

*Tjetra, në faqën 3, ku bëhet fjalë për sipërfaqe të mbrojtura dhe ku thuhet se sipërfaqet e burimeve të mbrojtura natyrore dhe mjedisore,*

*trashigimia e paluajtshme kulturore dhe arkeologjike. Duhet të kemi një formulim më të përcaktuar kur është fjalë për zbulime arkeologjike të rastit në prona private. Çka të bëhet në këtë rast? Mendoj se duhet paraparë një bashkëpunim me pronarin e vendit, ku është bërë gjetja, duke ia kompensuar me ligj lokacionin. Do të thotë duhet të parashihet në ligj me një pikë të veçantë. Në këtë rast do të përmend, sa për ilustrim, një shembull shumë të mirë – Dekretin italian të vitit 1931, ku shummirë është precizuar mbrojtja e lokaliteteve arkeologjike që në fakt ka të bëjë me socializimin e mbrojtjes së tyre.*

*Në fund, që të mos marr kohë, nuk do të shkoj mëtej se edhe u diskutua mjaf. Përkrah në parim ligjin dhe dëshiroj që të zbatohet sa më shpejt, ashtu me përmirësime dhe si duhet. Ju falemnderit*

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

*Deputeti Esat Dauti, le të bëhet gati Xhelal Canziba.*

v

### **z. ESAT DAUTI,**

**I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra të pranishëm,**

Pas të gjitha këtyre diskutimeve që i dëgjuam deri më tanë, mbesim pa fjalë se çka të shtojmë, unë kisha mund të shtoj vetëm këtë që komisioni i cili ka punuar për këtë ligj ka kryer një punë të madhe dhe duhet t'i falenderojmë dhe t'ju japim vullnet që të punojnë në avancimin dhe përmirësimin e disa të metave që kanë mbet në këtë ligj. Veçanërisht kisha me falenderu edhe pse u përmend mjaf Riçard Gejnor, puna e tij do të jetë një punë e madhe, i ka ndihmuar komisionit, por edhe gjithë neve. Mendoj që këtë ligj duhet ta begatojmë që niveli qëndror me nivelin e dytë komunal të jetë në lidhje reciproke, që të mund t'i realizojnë të gjitha ato që parashihen me këtë ligj.

Duhet të kemi pak kujdes në monumentet natyrore që i kemi, t'i përfshijmë në këtë ligj edhe monumentet tjera historike, mendoj arkeologjike. Ligji si ligj mendoj është mjaf i mirë me punën që do ta bëjmë në komisione, bashkarisht me ministrinë, pres që ligji do të jetë edhe në nivel më të lartë,  
Ju faleminderit.

## **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

***Zoti Xhelal Canziba, le të bëhet gati Fadil Kryeziu.***

### **Z. XHELAL CANZIBA,**

I nderuari kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë,

Nevoja për nxjerrjen e Ligjit për Planifikim Hapsinor, është e një rëndësie shumë të madhe për Kosovën. Sepse Kosovës i ka munguar një ligj i këtillë, i cili i referohet planifikimit. Me këtë ligj eliminohen zbratësitë në çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin hapsinor në të gjitha nivelet e planifikimit në Kosovë. Me këtë ligj garantohet trajtimi i barabartë për të gjitha format e pronësisë dhe për të gjithë personat në Kosovë. Ky ligj siguron aplikimin dhe adaptimin e ndryshimeve të cilat kanë ndodhë në Kosovë pas luftës, të cilat kanë të bëjnë me fushën e planifikimit të hapsirës, si dhe ofron mundësi të shfrytëzimit racional të hapsirës. Projektligji ofron zgjidhje adekuate dhe të avancuara për çështjet që i referohen kësaj sfere,

ndërsa Ligji i mëparshëm i Planifikimit Hapsinor nuk i adreson drejt problemet aktuale, për arsyet e ndryshme që kanë ndodhur në shoqërinë kosovare.

Sot në Kosovë mungon linja e ndarjes së vendbanimeve. Në tokën kosovare mund të shihet një kaos i vërtetë, një tragjedi e cila ngjet me tokën bujqësore. Nga shtëpitë e ngritura rishtaz të cilat janë ngritur në mënyrë brutale dhe të papërgjegjshme dhe me pasoja për të ardhmen e vendit, i cili deshi apo nuk deshi ta pranoj, pikërisht nga tokat bujqësore të punueshme është më së shumti i varur, edhe pse ky fenomen, sidomos pas periudhës së çlirimt të Kosovës nga regjimi serb, ka vazhduar të marrë masa të një egërsie të vërtetë arkitektonike.

Sa mund të korigojhet i tërë ky kaos dhe sidomos tërë ky dëm që i bëhet tokës bujqësore nga vetë pronarët, ku mund të thuhet, sidoqoftë ajo që mund të konkludohet qysh tash për t'u mos u bërë tepër von, duhet që në këtë drejtim të merren masa të parandalimit të ndërëtimit të mëtejshëm të vendbanimeve dhe shtëpive pa plan. Kosova është e vogël, prandaj zyrtarët e institucioneve përkatëse duhet të nxjerrin mësim nga tërë këto modele, sa të parandalimit, poashtu edhe të rregullimit, të hartimit të vizioneve dhe planeve konkrete se ku dhe si mund të ngrihen vendbanime, apo zona industriale për periudha të caktuara kohore.

Ajo që në këtë mes duhet medoemos të potencohej, është fakti që këto plane të cilat hartohen pikërisht nga ministritë, të koordinohen në institucionet për planifikim hapsinor dhe në koordinim me organet komunale. Unë e mbështes në parim Projektligjin për Planifikim Hapsinor. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

*Ju Falemnderit. Fadil Kryeziu, dhe i fundit, Sadik Idrizi.*

#### **Z. FADIL KRYEZIU,**

Z. Kryetar, i nderuar ministër, të nderuar deputetë,

Meqenëse jam ndër të fundit, dhe jo rastësisht jam ndër të fundit, prof. Esat Dauti, deputet i nderuar i këtij Parlamenti, në emër të Grupit parlamentar e përkrahu në parim Ligjin, mirpo unë dua ta themë vetëm një komponentë të rëndësishme. Për mendimin tim po e them në prani të ministrit, sepse ligji duhet të përpunohet edhe më tutje, por mendoj që është ndër ligjet e tralla që e përfshinë komponenten demokratike, atë që e harmonizon në njëfarë mënyre kompetencat e nivelit lokal dhe atij qëndror. Le mundësinë që komuna të angazhohet drejtëpërdrejt në ndërtimin e planeve urbanistike të qytetit dhe të fshatrave. Komponentë tjetër demokratike që mendoj se është e rëndësishme në këtë ligj, është mundësia e shqyrtimit publik, pra u jipet shansë qytetarëve që në kuadër të planifikimit hapsinor të Kosovës të thonë mendimin e vetë dhe duhet gjetë mënyrën dhe mundësinë që ai mendim, pra për të mbrojtur interesat e tyre të shkojë dhe të harmonizohet në kuadër të planifikimit hapsinor. Ajo që më brengos dhe në bazë të diskutimeve të shumta që u bënë në këtë ligj, është krijimi i ndjenjes se ndoshta ky ligj do ta zgjidhë definitivisht problemin e planifikimit hapsinor. Unë mendoj që duhet shumë punë për të bërë në këtë plan, pra edhe në ndërtimin përfundimtar të këtij Ligji. Ne e përkrahim. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Sadik Idrizi.

#### **Z. SADIK IDRIZI**

Dragi ministri, poštovani kolege,

Kratko samo u ime grupe ostalih zajednica. Mi ćemo dati podršku ovom Zakonu. Sigurono da će biti amandmana i da ćemo dati i tamo svoj doprinos. Medjutim,

najviše sam se javio zbog toga što na početku današnjeg zasedanja verovatno ste primetili da su poslanici iz drugih zajednica bili otsutni. Mismo bili pre nego što je počela sednica, ali smo se povukli. Danas u ovoj zgradi boravi šef za spoljnu politiku Evropske Unije g. Havijer Solana i ja hoću da kažem da su ovom prilikom kao i u mnogim drugim prilikama predstavnici drugih zajednica su zaobiđeni. Međunarodna zajednica je puna multietničnosti na Kosovu, međutim treba da bude primer da zaista ispoštuje jednu značajnu grupaciju koja je gotovo integrisana u kosovsku društvu i koja može biti primer kako bi trebalo da se na Kosovu rešavaju problemi i stvari. Druge zajednice imaju probleme, ali mi ih rešavamo i želimo da ih rešavamo institucionalno i učeščem. I svaki zaobilazak kao što je to tako i nedavno bilo sa Holandskim ministrom shefom misije OEBS-a u Evropi, koji je takođe zaobišao ove druge zajednice i to ne bi trebalo da postane praksa. Mi jesmo parlamentarna grupa od 10 poslanika u ovom trenutku u Parlamentu i predstavljamo više političkih subjekata i više etničkih subjekata i mislim da bi međunaroda zajednica trebalo malo više da nas respektuje ako želi da na Kosovu gradi budućnost. Hvala.

### **KRYESUESI Z. NEXHAT DACI**

**Z. Idrizi** plotësisht Seanca plenare ju përkrah në këtë. Kudo që ne jemi pjesëmarrës në përpilimin e ranglistës do të jeni të përfshirë. Pra, kishte shumë diskutime, shumë kontribute dhe ju ftoj se kush është që ta aprovojmë në parim Projektligjin e diskutuar.

Ju falëminderit shumë, a ka votë kundër, nuk ka kundër, a abstenon kush, nuk abstenon dhe 85 deputetë janë të pranishëm dhe konsideroj se ligji në parim është aprovuar. Dhe tash do të kemi 30 minuta pauzë. Ju falemnderit shumë.

#### ***Votimi – Glasanje – Voted:***

- *Për – Za – For ..... Të gjithë – Svi – All...*
- *Kundër – Protiv – Against ..... 00.....*
- *Abstenuan – Uzdrzanih – Abstaned...00.....*

***(Duartrokitje)***

(vijon pauza)

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

## PAS PAUZËS, SEANCËN E KRYESOI BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSERI, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT

### **KRYESUESI HYDAJET HYSERI:**

Janë të pranishëm 65 deputetë që do të thotë se kemi kuorumin e nevojshëm, prandaj mund të vazhdojmë.

Në radhë është shqyrtimi i parë i Projektligjit për Skemën e Ndihmës Sociale. Tekstin e projektligjit e keni marrë me kohë dhe për informimin tuaj, ky tekst është ndarë me 8 maj 2003, prandaj mund të konstatoj se janë krijuar kushtet për shqyrtimin e tij.

Nëse ndonjë deputet ose grup parlamentar ka ndonjë vërejtje gjatë materialeve tjera, tanë mund ta bëjnë, nëse jo mund të vazhdojmë.

Jemi në fazën e parë të shqyrtimit në parim dhe besoj se do t'i përbahemi. Sipas rendit fjala i jepet ministrit për Punë dhe Çështje Sociale. Z. Ministër e keni fjalën.

### **Z. AHMET ISUFI,**

Inderuari kryesues, të nderuar deputet.

Në çdo shoqëri demokratike është e drejtë themelore dhe njerëzore përkujdesja ndaj qytetarëve, apo shtresave sociale që është element i parë i cili mundëson krijimin e stabilitetit social. Projektligji për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, është hartuar në përputhje me mandatin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe në kuadër të kompetencave të Qeverisë së Kosovës.

Ky projektligj rregullon dhe qartëson të drejtat për ndihmë sociale. Është pjesë e domosdoshme e polilitikës së çdo Qeverie dhe detyrë më e ngutshme e saj për të eliminuar varférinë dhe përmes solidarizimit kombëtar, dhe ndarjes së drejtës së barrës që i kontribuon dinjitetit njerëzor, barazisë dhe drejtësisë sociale.

Të nderuar deputet, as në shtetet e zhvilluara nuk ka ndonjë model të vetëm të sigurimit social. Ai rritet dhe evoluon me kalimin e kohës. Egzistojnë skema të ndryshme të ndihmës sociale, skema univerzale, sigurim social dhe dispozita private ose unike. Secila shoqëri mendon në mënyrën më të mirë për të ofruar siguri të të ardhurave, për të garantuar çasje në mbrojtjen sociale dhe shëndetësore për qytetarët e saj.

Këto zgjidhje i pasqyrojnë edhe vlerat shoqërore – kulturore të çdo populli, duke i krahasuar ato edhe me nivelin e zhvillimit ekonomik. Në të gjitha këto shteti

ka rolin parësor në lehtësimin, promovimin dhe zgjërimin e përfshirjes së qytetarëve në sigurimin social si nacion, i cili mbërthen në vete forma të lloj-llojshme. Për realizimin e këtyre obligimeve që ka çdo Qeveri ndaj qytetarëve të sajë, duhet përbajtur edhe disa parimeve themelore. Në veçanti, përsitimet duhet të jenë të sigura dhe jodiskriminuese. Skemat duhet të drejtoshen në mënyrë të drejtë dhe transparente, me shpenzime sa më të ulta administrative, si dhe të sigurohet rol i fuqishëm për partnerët social. Faktor kyç për suksesin dhe realizimin e këtyre parimeve është besimi i shoqërisë në sistemin e skemave të sigurimit social, ku rol të rëndësishëm zënë edhe skemat e ndihmës sociale. Kurse për të krijuar besimin e plotë, esenciale është qeverisja e mirë.

Të nderuar deputet, Kosova që po kalon fazën e tranzicionit, ka filluar të ecë ngadal për mbarë. Jo vetëm në fushën e mbrojtjes sociale, por edhe në fushën e sigurimit social në përgjithësi. Në kuadrin e një strategje të përgjithshme të mbrojtjes shoqërore, është e qartë se duhet të rishikohet edhe skema e ndihmës sociale, por gjithnjë duke vazhduar përmirësimin e rrjetit të mbrojtjes sociale. Edhe në këtë projektligj të ndihmës sociale që është para jush, jemi përpjekur që t'i përbushim deri diku këto kritere që u theksuan më lartë. Skema e ndihmës sociale në Kosovë, në të ardhmen duhet të jetë kompetencë e pushtetit lokal. Në shumë vende të zhvilluara të botës kjo skemë është përgjegjësi e autoriteteve lokale. Kjo formë mund të jetë e realizueshme tek ne kur të bëhet një decentralizim i pushtetit, veçanërisht në fushën e mbledhjes së të ardhurave dhe të mirave materiale, të gjithë e dijmë se varfëria në Kosovë është ende shumë e përhapur.

Të dhënat e një raporti të fundit të vitit 2001, tregojnë se gati gjysma e popullsisë ka nivele konsumi nën nivelin e varfërisë të përcaktuar nga sasia e nevojshme për të siguruar një numër të caktuar kalorish në ditë. Të njejtat të dhëna tregojnë se 11% e familjeve janë nën nivelin e varfërisë ekstreme, kurse 39% e familjeve mund të kalojnë këtë cak me pak përpjekje. Shifrat e këtij Raporti unë mendoj se as tash në vitin 2003 nuk kanë shenuar ndonjë përmirësim të dukshëm. Prandaj, varfërinë duhet ta konsiderojmë si mungesë të aftësive dhe mundësive të qytetarit tonë, sidomos sa i përket nivelit ekonomik, i cili ka ende nevojë të madhe për një përkujdesje institucionale.

Të dhënat e përmendura më sipër, poashtu tregojnë se një rritje prej 15% e konsumit qon në eliminimin e varfërisë. Ky nivel prej 15% i nivelit të konsumit është i barabartë me 8.5 euro në muaj për një individ. Këto konstatime janë të mjegullta dhe kërkijnë më shumë përpjekje për të arritur një identifikim më të qartë të të varfërvë dhe një dallim më të mirë ndërmjet grupeve të ndryshme.

Të nderuar deputet, pas përfundimit të luftës, nga mesi i nëntorit të vitit 1999 dhe prillit të vitit 2000, administrata e UNMIK-ut zhvilloi një program emergjencë të asistencës financiare për ato grupe që kishin më së shumti nevojë. Kjo skemë e

përkohshme u zëvendësua më vonë me një skemë të re të asistencës sociale, e cila filloj të zbatohet në muajin Maj të vitit 2000, dhe funksionon si e tillë deri më sot.

Pra mbi bazën e kësaj skeme është hartuar edhe ky projektlilgj duke u modifikuar, por kuptohet duke e bërë më të qartë dhe më gjithpërfsirës aq sa na ka lejuar buxheti ekzistues i Kosovës. Standardet dhe normat ekzistuese evropiane parashohin pagesën e ndihmës sociale në baza individuale, mirëpo aktualisht në Kosovë një formë të tillë e pamundëson situata sociale, madhësia e familjes mesatare në Kosovë, e cila konsiderohet diku rrëth 6.3 anëtarë dhe çka është më kryesorja këtë e pamundëson buxheti shumë i kufizuar i Kosovës. Siç e dini edhe ju skema e deritanishme u ka paguar ndihmë sociale përafersisht pesëdhjetë e njëmijë (51000) familjeve me 181 mijë anëtarë, dhe për çdo muaj për këtë skemë ndahen 2 milion e 690 mijë e 475 euro. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ka përgatitur këtë projektligj, pas konsultimeve të gjëra me qendrat komuanle për punë sociale, Bankën botërore, USAID-in dhe një numër të madh të organizatave joqeveritare.

Përpos kësaj, dua të theksojë se hartimi i mëparshëm i skemës së ndihmës sociale, që është edhe burimi i këtij Projektligji, është bërë në konsultim edhe me partitë politike në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Njujork. Megjithë këto konsultime dhe pëlgjime paraprake, ne nuk konsiderojmë se kemi hartuar një projektligj i cili do t'i përfshinte të gjitha shtresat e shoqërisë sonë që kanë nevojë për ndihmën e institucioneve të Kosovës, por konsiderojmë se ky Projektligj avancon dhe qartëson akoma më shumë funksionimin e skemës së ndihmës sociale e çka është me rëndësi, nëse aprovohet nga ju deputet të nderuar, do të marrë formën e ligjit pëlotësishët të zbatueshëm dhe të një funksionimi të tij të përhershëm.

Në bazë të këtij projektligji të propozuar, të drejtën në ndihmë sociale do ta gjëzojnë familjet që i plotësojnë 2 kriterë kryesore. Kriterin jofinanciar dhe kriterin financiar. Kriteri jofinanciar përfshinë përbërjen e familjes dhe gjendjen shëndetësore sociale të anëtarëve të saj dhe varësisht nga ky kriter përfituesit e ndihmës sociale ndahen në 2 kategori: Në kategorinë e parë përfshihen familjet që plotësojnë kushtet e precizuara sipas përkufizimit të dhënë në nenin 1 pikën 7 të këtij Projektligji dhe kategorinë e dytë që përfshinë familjet me një anëtarë të familjes së paaftë për punë, me të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare ose që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën 15 vjeçare.

Ndërsa kriteri financiar përfshinë apo merrë në konsiderat të hyrat materiale të llogaritshme siç janë: "Të hyrat e fituara dhe të pafitaura, të hyrat e pranuara në mall, qiraja, dërgesat e parave, benificaciont që u jepen anëtarëve të familjes sipas Rregullores 2000/66, pensionet që merren nga jashtë dhe të mirat materiale të llogaritshme siç janë: Sendet me vlerë, pagesat e përgjithshme nga sistemi i pensioneve individuale të kursimit, siç parashihet me Rregulloren 2001/35,

pagesat tjera të përgjithshme, bizneset private apo familjare, prona, disa lloje të caktuara të pasurisë së patundshme, toka dhe automjetet që shfrytëzohen për përfitimin e të ardhurave në familje. Kurse të hyrat e pallogaritshme përfshijnë kursimet e anëtarëve të familjes, në llogaritë individuale të sistemit të kursimeve pensionale individuale të Kosovës, siç përcakton Rregullorja 2001/35. Prona e shfrytëzuar si vendbanim kryesor i familjes, automjeti i shfrytëzuar vetëm për nevoja shtëpiake. Ndërsa të mirat materiale të pallogaritshme përfshijnë: Pensionin themelor, pensionin e aftësissë së kufizuar, i cili tash është i hartuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, prodhimet shtëpiake për konsum familjar etj”.

Ky projektligj rregullon edhe mënyrën e paraqitjes së kërkesës, të drejtën në ankesë, shqyrtimin e ankesave, periudhën e shfrytëzimit, gjobat për dëshmi të rrejshme, administrimin dhe financimin, fshehtësinë e informatës dhe zbatimin. E veçanta e këtij projektligji është nen 11 i cili mundëson krijimin e një baze ligjore për dhënien e ndihmës financiare familjeve dhe individit në raste të jashtëzakonshme dhe këtu nuk është kusht që familja paraprakisht të jetë e përfshirë në skemën e ndihmës sociale, mirëpo nevoja e jashtëzakonshme sipas këtij Projektligji përkufizohet si nevojë e shpejtë e njëhershme e veçantë dhe e vazhdueshme dhe që nuk është paraqitur gjatë periudhës paraprake 12 muajëshe.

I nderuari kryesues, të nderuar deputet, objektiv i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është që të marrë sa më shumë vendime, dhe që të hartoje sa më shumë projektligje për t'i sjellë ato para jush. Qeveria dhe ministritë përkatëse janë ato që hartojnë projektligjet dhe vendime të ndryshme, të nevojshme për shoqërinë, kurse jujeni politika që i vlerëson ato dhe ua jipni vizën për t'u bërë të plotëfuqishme.

Dhe në fund, të nderuar deputet bashkë me projektligjin e ndihmës sociale keni edhe shpjegimet dhe arsyetimet e nevojshme, prandaj un nuk e shoh të arsyeshme që ato t'i lexoj para jush, por do të thoja vetëm një mendim që jam i sigurt se e ndani edhe ju. Kosova ka nevojë urgjente për plotësimin e infrastrukturës ligjore, jo vetëm për ta bërë Kosovën me ligje konform standardeve të shoqërive demokratike, por për të pasur çasje të drejtëpërdrejtë ndaj qytetarëve të saj. Ju faleminderit.

#### z. HYDAJET HYSNI,

Falënderojmë ministrin Ahmet Isufi dhe hapim debatin për shqyrtimin e Projektligjit për Skemën e Ndihmës Sociale.

## Znj. NAFIJE BERISHA.

I nderuari kryesues, të nderuar ministra dhe deputet.

Komisioni për Punë dhe Mirëqenies Sociale, në tri takimet e veta e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe me shumicën e votave është pajtuar që të përkrahet në parim edhe pse ka pasur vërejtje për plotësimet që janë të nevojshme të bëhen, mirëpo ato komisioni do t'i bëjë më vonë përmes amendamenteve.

Skema sociale është një segment i ndihmës sociale që i bëhet familjeve të varfëra pa kurrfarë burimi të të mirave materiale. Mirëpo Qeveria dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet në të ardhmen të përgatisin një ligj për mbrojtjen sociale, sepse ndihma sociale është vetëm një ndihmë në të holla për familjet nevojtare, kurse mbrojtja sociale e familjeve nënkupton diçka më shumë se vetëm ndihma në të holla siç është p.sh benificioni në shërbime publike, shëndetësore, ndihma në raste të jashtëzakonshme, ndihma e herëpashershme në ushqim, në strehim etj.

Kosova sot ka një numër shumë të madh të qendrave kolektive të strehimit, ku familjet jetojnë në kushte shumë të vështira dhe në rrethana higjenike të pa përballueshme, sepse ato objekte as për së afërmni nuk i plotësojnë kushtet për të jetuar në to. Ministria përkatësse duhet patjetër të bashkëpunojë edhe me asociacionet tjera, si dhe të sigurojë bazë ligjore për t,i ndihmuar këto familje për zgjidhjen e çështjes së strehimit dhe të udhëheqë politikën e vet me moton që të mbyllët edhe strehimorja e fundit.

Këto strehimore në Kosovë janë si pasojë e luftës, por edhe e gjendjes së vështirë materiale. Këtë fakt e dhashë vetëm për të ilustruar nevojën e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie familjeve për strehim. Në relacion me udhëzimin administrativ 20/2001 në të cilin ka mbështetje ky projektligj, krijon hapësirë më të gjërë për rritjen e numrit të shfrytëzuesve të kësaj ndihme sociale, sepse Udhëzimi administrativ i aprovar në vitin 2001 ka qenë shumë i kufizuar dhe një numër i madh i familjeve ka mbetur jashtë kësaj skeme, por megjithatë shumë gjëra kanë mbetur të rregullohen në këtë ligj dhe shumë me udhëzime administrative dhe në këtë projektligj nuk është plotësisht e qartë se cilat familje do të duhej të ishin shfrytëzuese të kësaj ndihme sociale.

Te përkufizimet patjetër duhet të hyjë edhe nocioni familje bujqësore, sepse kemi një numër shumë të madh të familjeve të cilat jetojnë në fshat pa asnjë të punësuar dhe me posedimin e tokës që kanë ata nuk mund të gëzojnë të drejtën për ndihmë sociale, kurse tokën që e kanë nuk mund ta shfrytëzojnë për shumë arsy, sepse toka e tyre nuk është tokë punuese, ose për shkak të mjeteve të punës që nuk i kanë. Pastaj në Kosovë mungon baza ligjore për mbrojtjen e prodhimeve bujqësore vendore, për kompensimin me rastin e dëmtimit të prodhimeve

bujqësore, si pasojë e rrethanave atmosferike, kështu që bujqësia nuk mund të konsiderohet si të hyra të asaj familje.

Kjo gjendje e rëndë e familjeve nëpër fshatra e nxit edhe migrimin e familjeve fshatare në qytet me shpresë se ata duke migruar në qytet do të jenë si gjëzues të kësaj ndihme sociale. Më së paku këtyre familjeve ju nevoitet një ndihmë e pjesshme materiale.

Problematik tjeter në kuadrë të kësaj është pengesa që familja të shfrytëzojë këtë ndihmë sociale, për shkak se ka munguar kategorizimi dhe nga Ministria kemi sqarim se mungon kategorizimi i tokës. Faktikisht, në asnjë nen nuk është i paraqitur, por kemi sqarime se duhet të paraqiten në një udhëzim administrativ, se një familje për të gjuar ndihmë sociale duhet të ketë minimumin gjysmë hektari tokë, atëherë ky kriterium nuk është në rregull se dikush mund ta ketë atë gjysmë hektari tokë djerrinë ose pyll që nuk mund të ketë kurrfarë përsitimi nga ajo. Andaj, unë mendoj se Ministria është dashur dhe duhet të bazohet në ligjin i cili para pak kohësh është aprovuar në Parlament-Ligji për krijimin e regjistratit për të drejtën pronësore mbi patundshmërinë. Në atë ligj diku bëhet kategorizimi i tokave dhe ky kategorizim të hyjë drejtëpërdrejt në ligj e jo të rregullohet me udhëzim administrativ, sepse përkundër 12 – 13 udhëzimeve administrativa që janë të parapara në këtë ligj. Edhe neni 13 parashev një udhëzim tjeter administrativ i cili do t'i rregullojë këto çështje, kështu që vet ligji pak a shumë i përngjan një udhëzimi në përgjithësi e jo neni. Mirëpo, megjithatë Komisioni e përkrah në parim ligjin dhe besoj se do të japë kontributin e vet përmes amendamenteve që ky ligj të jetë sa më i qartë dhe t'i shërbej popullit. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENI:**

*Falënderojmë deputeten. Pyes përfaqësuesit e komisioneve tjera – a duan ta marrin fjalën lidhur me shqyrtimin e Projektligjit në fjalë. Nëse jo, pyes përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Fjalën e ka deputetja Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.*

### **Znj. FLORA BROVINA**

Në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike e mbështes në parim Projektligjin për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë. Para nesh është versioni i 11 i këtij ligji dhe kjo tregon se sa ka pasur kujdes ligjdhënësi që ta marrë në shqyrtim çdo kritikë individuale, kritikë nga OJQ-të që merren me këtë çështje dhe ekspertët vendorë dhe ata ndërkombëtar. Mirëpo shtrohet pyetja, a është kjo

forma më e mirë e skemës sociale dhe një formë që preferohet edhe në ligjet evropiane për këtë çështje, gjithsesi jo. Është ky ligj i përpiluar në bazë të kushteve të varfërisë sonë, të buxhetit shumë të vogël të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe duke pasur parasysh problemet e shumta në këtë lëmi.

Të përkujdesemi për të gjithë ngapak. Ligji është mbështetutr dhe bazën e ka në skemën e ndihmës sociale të vitit 2000 të UNMIK-ut që është nxjerrë në fazën emergjente dhe Urdhëresën administrative 20/2001 si dhe doracakun e miratuar në vitin 2000. Janë bërë përmirësime sa i përket kategorizimit dhe shumës së pagesës, e cila do ta përcjellë edhe inflacionin, metodologjisë së punës, shpërndajes së ndidhmave etj.

Ligji në fjalë është shumë i komplikuar për ta kuptuar dhe i varur nga ligjet tjera, si nga ligji mbi pronën, kategorizimin e tokës etj. Gjithashtu realizimi i këtij ligji është në lidhje të ngushtë ndërministrore si bie fjalë me Ministrinë e Shëndetësisë, të Arsimit dhe ministritë e tjera. Ligji i komplikuar për një problem të rëndë dhe shumë të komplikuar, mbështetet nga ligjet e avancuara evropiane në këtë lëmë dhe deshëm apo nuk deshëm, kjo është një shkelje e të drejtave të individit. Të gjithë e kuptojmë këtë çështje dhe megjithate propozojmë që ta votojmë ligjin që është i domdosdoshëm për momentin me shpresë se ne në të ardhmen shumë të afërt do të mund të votojmë për ndryshimin e këtij ligji ose të aprovojmë ligj i cili është më i avancuar. Vërejtjet e mia konkrete janë edhe në lidhje me nenin 2. pika 2.2 dhe nenin 6. pika 6.1. Ato do t'i paraqes në komision.

I drejtohem Ministrisë për Punë dhe Çështje Sociale, mundësish në të ardhmen të na paraqes paket ligjesh shumë të nevojshme për momentin siç është Ligji i Punës, Ligji për benificione të invalidëve të luftës, për familjet që kanë të rënë në luftë, për familjet me persona të rrëmbyer dhe të pagjetur, në mënyrë që në paket t'i aprovojmë këto ligje që sa më parë të kemi edhe mbrojtjen e tyre institucionale. Ju faleminderit.

## **KRYESUESI HYDAJET HYSENI:**

*Fjala i jipet deputetes Zylfije Hundozi, në emër të Grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Prej Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk është paraqitur askush, si grup, por në radhë është Fetije Këpuska... Aha, qenka paraqitur. Atëherë, do të tërhiqja vërejtjen që tjetren herë, kur të bëhet paraqitura për diskutim, të shënohet ose t'i thuhet përfaqësuesit të Sekretarisë që të shënojë se është fjala për: si deputet, apo përfaqësues i grupit parlamentar. Urdhëroni zonja deputete.*

### **Znj. ZYLFİYE HUNDOZI,**

z. Kryesues, zonja dhe zotërinj deputet,

Projektligji i ndihmës sociale është tentim i përmirësimit të Udhëzimit administrativ 20/2001, me të cilin deri më tanë është rregulluar dhënia e ndihmës sociale në situata emergjente të pasluftës. Përveç asaj që shumat e deritanishme janë rritur në 5 euro, me këtë projektligj tentohet që në mënyrë sa më reale të bëhet vlerësimi i atyre familjeve të cilat kanë me të vërtetë nevojë për këtë lloj ndihme. Me kategorizimin e familjeve të cilat kanë nevojë për ndihmë sociale bëhet më e kuartë se cilat familje kanë nevojë për ndihmë, dhe qartësohen mekanizmat e identifikimit të tyre duke u zvogëluar keqpërdorimet. Me këtë projektligj parashihet edhe dhënia e ndihmave materiale në situata të jashtëzakonshme, duke krijuar bazë statutare për këtë e që deri më tanë nuk ka ekzistuar, por më lejoni që t'i theksojë edhe vërejtjet tona në këtë projektligj.

Mendoj se titulli i drejtë është Projektligji i ndihmës sociale e jo i skemës sociale. Qëllimi për të cilin është bërë ky ligj është përmirësimi i jetës së familjeve të të varférve në Kosovë e që kjo nuk është arritur. Shuma minimale e ndihmës sociale për një familje është 35 euro për një anëtar, e për 9 anëtarë është 75 euro. A mund të sigurohet ekzistenca minimale e këtyre familjeve në këtë shumë, kur kostoja e jetës në Kosovë, sidomos pas ndërrimit të valutës prej markës gjermane në euro, është shumë e lartë. Në këtë projektligj ceket që kjo shumë mund të rritet viteve të ardhshme, sipas shkallës së inflacionit, mirëpo unë mendoj që tanë duhet të rritet shuma primare e ndihmës që përafërisht tu ndihmohet të varférve të mbijetojnë.

Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në parim e përkrah realizimin e këtij projektligji. Me punën tonë në komisionin përkatës, me propozimet tona, shpresojmë se do ta begatojmë. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENI:**

*Ju falemnderit. Fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Sabri Hamiti. Urdhëroni.*

### **Z. SABRI HAMITI,**

Unë po e njoftoj Kuvendin se grupi ynë ka mbajtur mbledhje të vëçantë rreth këtij ligji.Për këtë kemi diskutuar në pika gjenerale dhe në pika të vëçanta,kështu jemi marrë vesh që në parim ta përkrahim këtë ligj, sepse e shohim si të domosdoshëm për një veprimitari kaq të rëndësishme ,për gjendjen sociale të popullatës, pra në parim do ta përkrahim këtë ligj me plotë vërejtje të cilat janë shqyrtuar në mbledhjen e grupit parlamentar, ku në një mënyrë do të shpalosen nga diskutuesit e vëçantë që kanë të drejtën e observimeve të veta në seancë.

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENI:**

*Falënderojmë deputetin Hamiti. Në radhë është deputetja Fetije Këpuska. Le të përgatitet Sabile Basha.*

### **Znj. FETIJE KËPUSKA**

**Kolegë deputet, të nderuar ministra.**

E konsideroj me interes të arsyeshëm dhe të domosdoshëm shtruarjen në rend të ditës si dhe miratimin e skemës së re të ndihmës sociale në Kosovë. Është thënë edhe më herët ,në materialet e prezantuara për këtë mbledhje, se këtë skemë duhet përmirësuar dhe plotësuar në pajtim me rr Ethanat e reja, me mundësitetë dhe nevojat reale të familjeve respektivisht të popullatës së Kosovës. Pra, skema sociale duhet të jetë sa më reale dhe në pajtim me rr Ethanat, kërkosat e familjeve dhe mundësitetë e shoqërisë kosovare. Skema e deritashme ,siç thuhet edhe në projektpropozim, është e tejkaluar në shumë aspekte, pasi që vetveti ajo ishte paraparë si një skemë emergjente në rr Ethanat e pasluftës.

Rr Ethanat në ndërkohë kanë ndryshuar në shumë aspekte – segmente. Dikund janë përmirësuar e në të shumtën e rasteve janë përkeqësuar.Fatkeqësisht ka

vazhduar dhe po vazhdon varfërimi i popullatës së Kosovës, i familjeve dhe i individëve, për këtë arsy e modernizimi dhe kompletimi i sistemit të mbrojtjes sociale duhet të jetë me përparësi dhe preokupim i vazhdueshëm i Qeverisë së Kosovës. Ndërkaq ,skema e re sociale duhet të ketë një mbështetje, një legjislacion bashkëkohës, natyrisht me specifikat tona.Në këtë kontekst duhet përfituar nga përvoja e legjislacioneve të vendeve të Bashkimit evropian, si dhe të përcaktohet strategjia e këtij sektori me interes jetësor. Pos hartimit të ligjit për këtë qëllim , është e nevojshme të përcaktohen të përcaktohen edhe objektivat, priorititetet si dhe buxhetet për këto dedikime, kuptohet krahas zgjërimit të shërbimeve sociale. Në këtë kontekst duhet përcaktuar garancitë ligjore të nevojave të jetesës në familje për të ardhurat apo për ata pa të ardhura, në minimum të jetesës, si dhe individët me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore.

Si prioritet duhet të trajtohen individët dhe familjet e rrezikuara për ekzistencë. Duhet siguruar një menaxhim të mirë, të drejtë të këtij aktiviteti, si dhe të funksionalitetit dhe të efikasitetit të këtyre shërbimeve. Ndihmat duhet të jenë të diferencuara nga njëra familje në tjetrën, nga një rast në tjetrin , natyrisht në bazë të një vlerësimi të kushteve sociale, ekonomike të familjeve përfituese nga këto fonde, e jo të zbatohet një barazi skematike dhe lineare. Paraprakisht, duhet bërë një evidencim gjithpërfshirës i gjendjes materiale, si dhe i të gjitha të mirave materiale dhe të të hyrave. Të tëra këto me qëllim që mjetet e dedikuara vërtet të orientohen në ato familje të cilat i ka pllakosur varfëria e skajshme.

Numri i këtyre familjeve siç dihet është shumë i madh. Supozohet se shumë familje kanë nisur të konsolidohen, të mëkëmben si një. Pas luftës për familjet kosovare ndaheshin ndihma emergjente në ushqime, veshëmbathje, kurse tash ato janë simbolike, apo janë shuar fare. Një numër familjarësh pas luftës kishte gjetur punë në organizatat e ndryshme joqeveritare – humanitare si : përkthyesh, punëtor administrativ apo vozitës, ndërsa disa familje siguronin të ardhura nga qiraja që merrnin nga të punësuarit ndërkombëtarë.Tash numri i tyre është në rënien të dukshme, pra në ndërkohë ka ndryshuar gjendja reale e shumë familjeve. Për bazë është paraparë të merret familja e jo individi.

Së këndejmi, është e domosdoshme të bëhet një regjistrim i plotë dhe i saktë i gjendjes reale materiale të secilës familje, duke përfshirë numrin e anëtarëve si dhe të gjitha burimet e të ardhurave, të mirave materiale dhe të gjitha burimeve të ekzistencës. Në këtë drejtim është e domosdoshme që regjistrimi i gjendjes reale të secilës familje të bëhet realisht me të gjitha të dhënat, ndërsa personat t,i deklarojnë të dhënat e sakta të verifikueshme në mënyrë që me to të mos manipulohet .

Një vëmendje të veçantë duhet kushtuar familjeve të viseve të përfshira nga lufta që kanë pasur më së shumti dëme. Në këtë drejtim duhet përkrahur dhe siguruar

familjet e dëshmorëve dhe të të rënëve , familjet e personave të zhdukur, personave me aftësi të kufizuara, fëmijët jetim dhe familjet dhe personat e tjerë të rrezikuar . Përkujdesja për një numër kaq të madh të familjeve kosovare ,duhet të jetë institucionale ,e pérhershme dhe adekuate. Me skemën e re sociale duhet caktuar një prag ekzistencial që do të nënkuçtonte përbushjen e kërkësave më elementare të jetës, që do të shërbente si bazë për caktimin e shumës së ndihmave konkrete për familje dhe individ.

Strategjia e shërbimeve sociale duhet të ketë për pikënisje filozofinë që mbështetet në parimet e modelit social të vendeve evroperëndimore, dhënien e prioriteteve shërbimeve sociale në raport me të ardhurat, aplikimin e standardeve bashkëkohore, si dhe rritjen e qëndrueshmërisë dhe të vazhdueshmërisë së shërbimeve sociale. Për këtë arsyе duhet siguar kalimin nga politika sociale në shërbime sociale parandaluese,Sigurimin e fondeve dhe shpërndarjën adekuate të tyr.Realizimi i kësaj të drejtë do të zgjedhonte në një masë edhe dëshirën dhe qëllimin e mërgimit të shumë të rinjëve kosovarë mu për shkak të gjendjes së vështirë materiale. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENI**

Fjalën e ka deputetja Sabile Basha, ju lutem të keni kujdes për kohëzgjatjen e diskutimeve.

### **SABILE BASHA**

Të ndëruar deputetë, të ndëruar ministra,

Thuhet teoritikisht se çështjet sociale në çdo anë të botës kanë të njëjtin mocion dhe të njëjtin emër. Megjithate, në rastin e Kosovës ky fenomen ka frymuar dhe frymon më ndryshe nga vendet e rajonit. Nga e kaluara jo e largët, Kosova ishte dhe mbeti ndër vendet më të pazhvilluara në tërë Europën,edhe përkundër resurseve shumë të pasura natyrore dhe njerëzore të saja. Është e qartë se Kosova ishte ajo hapësirë e pasur nga e cila okupusi kishte grabitur duke lënë një varfëri të tejskajshme, por kulminiacioni u arrit pas vitit 1989, kur regjimi i atyre viteve u kujdes me të madhe për mbylljen dhe plaçkitjen e shumicës së ndërmarrjeve dhe hudhjen në rrugë edhe të atyre pak punëtorëve shqiptarë ,që ishin afro 150.000 e që përbënин më pak se 1 të dhjetën e popullsisë të përgjithshme shqiptare në Kosovë, në mënyrë që më vonë të kemi një odisejadë edhe më të dhëmbshme për popullatën shqiptare.

Si rezultat i krejt kësaj ishte ikja më shumë se gjysmë milioni të rinjsh në perëndim, me një fjalë në vitet 89/99 u bë suprimimi dhe paralizimi komplet i

jetës institucionale politike, ekonomike dhe arsimore e shkencore të shqiptarëve në Kosovë.

Deputetë të nderuar, papunësia dhe mungesa e aktiviteteve ekonomike llogariten ndër problemet fundamentale të pasluftës, të cilat preknin pjesën më të madhe të popullatës shumicë shqiptare të Kosovës dhe sipas disa të dhënave që disponojmë, llogaritet se në Kosovë papunësia ka arritur shkallën 70% të popullsisë, ndërsa më tepër se gjysma jeton në varfëri dhe afro 12% në varfëri të skajshme.

Andaj, për zbutjen sadopak të gjendjes së rëndë sociale që nga viti 2000 sipas udhëzimit administrativ 20/ 2001 Departamenti kalimtar i punës dhe qendrës sociale në nëntor të vitit 2000 filloi të aplikojë skemën e ndihmës sociale, dhe në skenën e tanishme të ndihmave sociale ka arritur të përfshijë afro 51.000 familje, mirëpo me draftligjin që e kemi sot në shqyrtim, mendoj se aty parashihen reforma avansuese dhe gjithsesi do të arihet një e kulibër social në vend duke bërë përfshirjen e një spektri sa më të gjerë të nevojtarëve në skemën e ndihmës sociale. Gjatë shqyrtimit të Projektligjit, në Komision kemi pasur hezitime rreth disa paqartësive se kush e gjzon të drejtën për të marrë pjesë në skemën e ndihmave sociale, për shkak se nuk janë të definuara mirë kategoritë e personave që mund të merrnin pjesë në to, siç ishin:

Invalidët e luftës dhe viktimat e luftës, familjet e dëshmorëve, familjet pa meshkuj në shtëpi, të përndjekurit e ndërgjegjes gjatë Jugosllavisë, fëmijët pa prindër, personat që gjatë luftës humbën pasurinë, personat me aftësi të kufizuara etj. Por, pas një konsultimi me këshilltarin e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies sociale ne kuptuam se në Ministri po punohet për një Draftligj të ri për të gjitha këto kategori dhe ishim të mendimit se na nevoitet një ligj i tillë që në mënyrë institucionale do të ndihmojë pjesën më të varfër të shoqërisë, që tani nuk është e vogël. Mendoj se ky Projektligji i plotëson kushtet që të jetë i realizueshëm për ne dhe i përshtatshëm për kushtet dhe rrethanat tona të tanishme. Nga ana tjetër, eliminon zbrastësitë ligjore në fushën e skemave sociale si dhe hap mundësitë që të nxirren edhe një mori aktesh ligjore, të cilat do të mundësonin zbatimin efikas të tij. Ju faleminderit për vëmendje!

## **KRYESUESI, HYDAJET HYSENI**

Fjalën e ka Fatmir Sejdiu, deputet dhe anëtar i Kryesisë.

## **FATMIR SEJDIU**

Faleminderit z.kryesues,z.ministra, të nderuar kolegë dhe deputetë, Do të përpinqem të jemë shumë i shkurtër pa elaboruar nevojën, sepse para nesh kemi një projektligj. Mendoj se ka diçka që përsëritet, e këtë e kam thënë edhe në mbledhjen e Kryesisë. Fjala është pikërisht për ndilemën se a do të vazhdojmë me

vërejtjet e një standardi që përsëriten në çdo seancë plenare. Është shumë me rëndësi të dihet modeli i hartimit të ligjit. Këtu nuk është fjala vetëm për ministrinë, është fjala edhe për ekipet që finalizojnë variantin e projektit definitiv, pra edhe në Kryesi.

Duke marrë parasysh shtojcën 7 të pjesës 11 të misionit të Administratës të përkohëshme të Kobeve të Bashkuara në Kosovë, lexone njëherë dhe unë nuk do të ndalem më tej këtu. Mendoj se nga çështja që u prekën, shumë esenciale është ajo çështje që e shtroi z. Hundozi, pra çështja e një skeme e cila parashtronet në nenin 8. "Kriteret e përcaktimit të saj dhe mënyra e shpërndarjes dhe e dhënieve së ndihmës". Unë nuk do të hyjë në shifra, por do të hyjë vetëm në logjikën e hartimit. Mundësitetë potenciale financiare mund të jenë diçka tjetër që arsyetojnë, por atje mund të bëhen përpjekje të tjera. Për një anëtar të familjes jepen 35 €, për 7 të tjerë 40 euro plus, mangu 6 anëtarë të familjes. Mendoj se kjo është e paqëndrueshme.

Mendoj se pavarësisht nga ky fakt i shruar këtu, nuk është në rregull që këto shifra, sikur që ishte rasti edhe me pensionet themelore, të jenë pjesë përbërëse e ligjit këtu. Projektuesi i draftit ka lënë mundësinë që në vitet në vijim të përcaktojmë me vendim të posaqëm të Ministrisë bazë kriteret që përcaktojnë njësitë e tjera përmes mënyrën e ndarjes apo të mbrojtjes sociale. E njejtë gjë vlen edhe përkëtë rast. Ne i kemi mangu edhe 6 muaj kur duhet të hyjë ligji në fuqi dhe është një pjesë e ligjit që bjen nga fuqia menjëherë dhe dispozitat që janë përcaktuar më vonë në kuadër të nenit 8 udhëzojnë një mënyrë më parimore të vendosjes. Nuk do të ndalesha shumë në çështjet e tjera, sepse do t'i bashkangjes vërejtjet. Në nenin 2, skema e ndihmës sociale do të japë ndihmë sociale. Është shumë e qartë se skema nuk jep ndihmë, por përcakton kriteret që janë pjesë përbërëse të këtij ligji. Ka edhe çështje të tjera që vërtet nuk dëshiroj t'i bisedoj se ndoshta janë të përsëritura sa e sa herë, por do të kemi rast që të komunikojmë më drejtëpërdrejt edhe me pjesët apo me njerëzit a me trupat punuese nga Ministria apo Kuvendi që punojnë që draftet të vijnë të përgaditura sa më mirë. Ju faleminderit!

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENI:**

*Falënderojmë deputetin Sejdiu. Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi, le të përgatitet Sanije Alijaj.*

### **IBUSH JONUZI**

Z. kryesues, kryesi e punës, deputetë të nderuar dhe ministra,

Projektligji për skemën e ndihmës sociale, siç është propozuar, është mjaft i mirë, mirëpo, realizimi i tij praktik do të jetë shumë i vështirë për shkak të disa paqartësive. Natyrisht, ka disa lëshime pa të cilat projektligji në fjalë do të ishte në nivelin e duhur, por gjatë fazës së punës në komisione ka mundësi që ato mangësi të korigohen.

Në pjesën e Projektligjit për skemën e ndihmës sociale ku ceket se duhet të jetë ndihma e familjeve me gjendje të vështirë ekonomike në Kosovë, nënkupton se ky projektligj më shumë përqëndrohet në familje se sa tek individët. Këtu mendoj se duhet shtuar edhe personat të cilët janë me të meta të rënda, pasi që në tërë botën kanë një trajtim të veçantë social. Këta persona ceken në projektligj në nenin 1.9, ku personat e kategorizuar nga Komisioni mjekësor me 80% të paaftësisë hyjnë në skemën e ndihmës sociale vetëm në kuadër të familjes.

Sipas nenit 3.pika 1b, familja largohet nga Skema e ndihmës sociale vetëm pse fëmija ka kaluar moshën 5 vjeçare, gjë që vjen në kundërshtim me pasusin e parë të përbledhjes së propozimit të Skemës së ndihmës sociale dhe është një shkelje e rëndë e të drejtave të fëmijës. Këtu jepet një arsyetim formal ku e tëra bëhet për ruajtjen fondeve, kur ka shumë mundësi të tjera për ruajtjen e fondeve në mënyrë shumë më efikase. Në nenin 4.5. thuhet se posedimi i utomjeteve nuk e kushtëzon largimin e familjes nga Skema e ndihmës sociale, nëse përdoret vetëm për nevojat familjare. Kisha për të pyetur sa shpenzime shkojnë rreth mirëmbajtjes së automjetit brenda një viti. Këtu përjashtim duhet të kenë vetëm familjet që posedojnë automjet, por që ngasësit e tyre janë prersonat me aftësi të kufizuar. Si do të reagojë pala tek punëtorët profesionalë zyrtarë nëse është i refuzuar për shkak se fëmija i tij ka kaluar moshën 5 vjeçare, ndërsa pala tjetër me automjet shfrytëzon të drejtën në skemë në asistencën sociale.

Neni 1 pika 5 në tretmanin e fëmijës jetim duhet të futet edhe fëmija të cilit njëri prind i ka vdekur, kurse tjetri e ka braktisur. Në parim e përkrahu projektligjin. Ju faleminderit!

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENİ:**

***Falënderojmë. Fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj, le të përgatitet Teutë Hadri.***

## SANIJE ALIJAJ

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë dhe ministra.

Sot k ur p o bëhet leximi i parë n ë parim i Projektligjit p ër skemën e ndihmës sociale, unë para Kuvendit të Kosovës do të shpreh një shqetësim të madh.

Komisioni p ër personat e humbur d he t ë k idnapuar n ë k uadër t ë v izitave q ë u bënë familjeve q ë kanë personat të humbur dhe t ë kidnapuar me d atën 30 maj 2003 vizitoi familjet në Krushë t ë Madhe dhe n ë Krushë t ë vogël. Në takim me gratë kryefamiljare, p ërvëç rrëfimeve trishtuese t ë tyre p ër numrin aq t ë madh t ë t ë dashurëve t ë tyre t ë cilat rrëfehen se njëra i ka 16, t ë humbur tjetra 12, tjetra burrin e 4 fëmijë e kështu me radhë, konstatuam se ato gra ballafaqohen me një varfëri t ë p askajshme, i ngrisin fëmijët e tyre dhe i shkollojnë me një ndihmë sociale prej 65 euro. Nga pamja q ë pamë ne nga ato takime ato ishin gra t ë dërmuara me dhembje p ër t ë humburit e t ë dashurve t ë tyre dhe me ballafaqimin e vështërsive t ë jetës.

Gratë n ë këto dy fshatra janë pa profesione dhe t ë pa punësuara, gratë kryefamiljare q ë mbajnë familjen me punën e krahët e tyre. Kam bër p ërpjekje q ë gjatë leximit t ë këtij projektligji ku ti futim këto kategori t ë grave kryefamiljare q ë kanë njerëz t ë tyre t ë dashur t ë humbur dhe t ë kidnapuar, Nga kriteri finansiar i këtij Projektligji kërkohet vërtetimi i gjendjes materiale duke p ërfshirë t ë mirat materiale dhe t ë hyrat e anëtarëve t ë familjes, por çfarë t ë hyra materiale kanë këto gra kryefamiljare? Kur t ë gjitha janë t ë pa profesion dhe t ë gjitha janë pa kryefamiljarë. Kanë ndoshta një pasuri t ë patundëshme, po ku e kanë krahun e tyre t ë punës p ër t ë krijuar t ë mira p ër jetë.

Unë kam theksu n ë veçanti q ë gratë e Krushës së Madhe dhe gratë e Krushës së vogël, Komisioni ka vizituar edhe vendbanimet tjera q ë kanë n umër t ëmadh t ë këtyre familjeve. Është e njejtë gjë edhe në Mejë, e njejtë gja edhe në komunat tjera.

Komisioni n ë takimin e djeshëm ka marr vendim q ë t 'i drejtohet Ministrisë p ër punë dhe çështje sociale, Qeverisë së Kosovës, Komisionit t ë Qeverisë së Kosovës edhe Presidencës së Kosovës më kërkësë q ë urgjentisht t ë nxjerret ligji p ër familjaret q ë kanë personat e humbur dhe t ë kidnapuar dhe t 'i marr n ë p ërkujdesje institucionale këtë kategori t ë familjeve tonë. Por unë do t ë dal me një propozim konkret, shiqoni edhe në Projektligj, p ër t ë fituar t ë drejtën e ndihmës sociale familjet duhet t ë mbushin një formular administrativ q ë e lëshon Ministria p ër Çështje Sociale, edhe duhet t 'i japid t ë gjitha informacionet p ër ndryshimin e rrëthanave gjatë gëzimit t ë asaj asistence. Merreni me mend se n ë çfarë pozite i vëjnë këto gra kryefamiljare, t ë shkojnë derë p ër derë t ë kërkojnë një troh p ërkujdesje , ju lutem kjo është ndërgjegjja e shoqërisë së Kosovës e n ë

veçanti i institucioneve të Kosovës. Pse e theksoi për shkak se familjet që kanë personat e humbur dhe të kidnapuar janë pa status të zgjidhur. Prandaj, deputet tē nderuarë po t'i shihni ashtu siç i pa Komisioni për personat e humbur dhe të kidnapuar nuk do të rini qetë në shtëpi pa e ba një zgjidhje urgjente, po t'i shofin edhe ministrit tonë do të ndërmernin një hap konkret shumë të ngutshëm.

Personalisht propozoj, që Ministria për Çështje Sociale së bashku me Ministrinë e Arsimit por edhe me Ministrinë për Ekonomi e Financa, urgjentisht tē fillojnë hartimin e projekteve ekonomike për të krijuar kushte për punësim që ato në mënyrë të denjë t'i risin fëmijët e tyre, e Ministria e arsimit tē hartojë projekte për pregaditjen e tyre profesionale që të punojnë në këto projekte ekonomike. Prandaj, ne para disa dite dy muajt e tërë (me 10 qershor bëhen dy muaj) do të bëhen që Kuvendi e ka aprovu një rezolut për personat e humbur dhe të kidnapuar. Deri më sot Komisioni ka konstatuar se asnjë pikë e asaj rezolute nuk ka filluar realizimin në praktik, prandaj, ne shumë shpejtë si Komisioni do të kërkojmë edhe përgjigjen me shkrim që të ndërmerrët urgjentisht zgjidhje dhe përkujdesje institucionale e këtyre familjeve. Ju faleminderit.

### **BASHKËKRYESUESI: Hydajet Hyseni**

Fjalën e ka deputetja z. Teutë Hadri, edhe një herë e tërhjeku vërejtjen që të përqëndrohem i në çështjen që po shqyrtojmë, me gjith mirëkuptimi me çështjen që shtrohen dhe të kemi kujdes kohën.

### **TEUTA HADRI**

Të nderuar deputetë, i nderuar z.kryesues.

Këtë vërejtje desha tju jap edhe juve, që në seancat e ardhshme tē caktohet tema dhe rendi i ditës, se me të vërtet është e tepërt që të na maltreton neve me ligjerata këtu. Ne gjith e kemi marr projektligjin kemi analizuar çka do të thot Projektligji.

Qëllimi është që ky projektligj tē pasurohet e ato nene që n'a duken tē tepërtë kemi propozime për ta kompletuar, tē jetë ma e saktë ato tē propozohen. Prandaj unë do të jem e shkurtë, më vjen keq se nuk paraqiten dhe të tërhiqen ato vërejtje që ka nevoj ky ligj tē jetë më funksional. Propozimi i një Projektligji tē tillë ka qenë më se i nevojshëm nga ditët e para tē punës tē këtij Parlamenti dhe nga ditët e para tē pas luftës ne jemi ballafaquar me probleme shumë të mëdha sociale e që këto probleme so ciale arritën që popullatën tanë ta ndajnë në dy shtresa. Në kategori dihet siq ceket këtu, kategori sociale tē rënduarë. Prandaj, edhe sot nuk është vonë dhe ky parlament tē bëjë meratimin e këtij Projektligji njihet edhe Ministrisë përkatëse ju uroj sukses që sa më shpejtë ky ligj tē vjenë në propozim.

Unë i kam tri vërejtje z.kryesues, që vërejtja e parë është si vërejtje terminologjike, vërejtja e dytë është që z.Fatmir Sejdiu që vec e tha, unë nuk do

ta përsëris ate dhe vërejtja e tretë është rreth trajtimit në raportet familjare te personat me aftësi të ngecur.

Vërejtja e parë termilogjike, kemi vërejtur një mospërputhje jo vetëm në terminologji po edhe në përbajtjen e verzionit. Në gjuhën shqipe po hasim propozim ligj, anglisht low e dikund tjetër drafligj që nuk është e ngajashëm dhe nuk ka nevojë të precizohet. Vërejtjen tjetër në gjuhën shqipe kemi, flitet për bazën juridike të një ligji duke u thirur në disa ligje tjera, kjo ishte vështirë që një ligj të ketë bazë juridike dhe të mbështet në një ligj tjetër, prandaj edhe këtu duhet një përmirësim. Në gjuhën anglisht kemi "legjislativë" legjislativi përkatës apo gjegjës, në gjuhën shqipe është ba një mos trajtim adekvat i kësaj fjalë, në gjuhën shqipe kemi familje përzgjedhur që do të thotë çka është kjo fjalë familje përzgjedhur me të vërtet është një ngarkesë edhe një pasqyrë shumë e mirë te popullata jonë të ndahen familje e varfér dhe e pasur e përzgjedhur ndoshta kta le të na e skjarojnë ma mirë është shumë peshë e rëndë që në popullatën tonë të krijohen kësi shprehje. Prandaj shtrohet nevoja për një punë efektive në harmonizimin e teksteve në gjuhë, është mjaft e domosdoshme.

Vërejtja e dytë siç e tha z.Fatimir në nenin 8, unë nuk dua ta zgjas më tepër mirëpo këtu është e nevojshme që të bëhet një analizë dhe ndarje më e kuartë se në bazë të numrit të anëtarëve, se një anëtar psh. i ka 35vjet tjetri 50 që do të thotë dyfishi. Nëse shtohet numri i anëtarëve për çdo anëtarë shtohen vetëm 5 euro këtu nuk duhet të bëhet një analizë më e saktë,

Vërejtja e tretë është te familjet me ngarkesa dhe ngecje shëndetësore, psiqike te ato familje jo vetëm të trajtohen me mjek këta persona por duhet edhe anëtarit të familjarit të tyre që i jan në përkujdesje të këtyre personve të trajtohen disi edhe të kenë beneficione më të përshtatshme për shoqërinë tonë se ne vet si mjek e dimë çka do të thotë, të jesh pjesëtar i një familje me një person hendikep, prandaj duhet të ritet morali që këtyre anëtarëve t'ju ndihmohet. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENİ**

Fjalën e ka Remzije Nimani të pregaditet Mevlyde Saraçi.

### **REMZIJE NIMANI**

Zoti kryesues, të nderuar deputet, dhe ju ministra,

Regullorja mbi realizimin e ndihmës sociale ka filluar të funksionoj që nga viti 2000, duke u relizuar nëpër qendrat për punë sociale dhe ka dhënë efekte të duhura për skamnor. Por praktika e përgjithshme tregon se kjo skemë nuk ishte aq e drejtë dhe ishte mjaft e komplikuar për tu realizuar. Fillimi është kjo skemë u dedikohet të varférve. Por të varférët e vërtetë nuk mund ta realizojnë ndihmën sociale për shkak të byrokratice ose komisioneve në qendrat për punë sociale të cilët i eliminojnë nga kategoria e kritereve finansiare e jo finansiare. Disa familje

pa asnë anëtarë të punësuar nuk e kan gjuar ndihmën sociale. Nga familja që nuk ka asnë anëtarë të punësuar kërkohet të ketë një fëmijë nën moshën 9 vjeçare e nëse nuk e plotëson këtë kriter përashtohet nga ndihma sociale, gjë që nuk është në rregull.

Përsëritja e kërkesës për ndihmë sociale në çdo gjashtë muaj është jo e arsyeshme. Prandaj, propozoj që kjo të bëhet një vit. Vlerësimi i të hyrave materiale duhet të përcaktohet më parë e jo të lejohet vetëm punëtorëve të qendrave për punë sociale. E drejta Europiane parashef pagesat e sigurisë sociale në baza individuale, nga papunësia. Kjo nuk parashifet në Kosovë përbëhet vetëm për familje. Shtroj pyetjen, pse ndodh kjo? .

Ky ligj parashef skemën e 51.000 familjeve për ndihmë sociale dhe 26.000 personave mbi 65 vjeçar për pension. Që të dy këto kategori më tepër i takojnë ndihmës sociale e jo pensionit sepse kriteri i vetëm për pension është mësja 65 vjeçar. Por nuk duhet ngatruar ose barazuar pensionin me ndihmën sociale, dhe familja që ka pension drejtëpërdjret largohet nga ndihma sociale. Kriteret për ta realizuar ndihmën sociale me një fëmijë nën moshën 5 vjeçare dhe një jetim 15 vjeçarë është i pa arsyeshëm, sepse eliminon shumë skamnor që të gëzojnë të drejtën për ndihmë sociale. Kriteri nëse familja ka 0.5 hektarë tokë nuk mund ta gëzojë ndihmën sociale, nuk është i arsyeshëm nga se pas lufte mungojnë mjetet për të punuar tokën dhe se cilësia e tokës është e ndryshme.

Ndihmat nga të afërmit nuk duhet marrë si kriter për mosrealizimin e ndihmës sociale. Pagesa minimale prej 10 euro është shumë e ulët, vlerësoj që ajo duhet të rritet. Personat që gëzojnë ndihmë sociale duhet të lirohen nga participimi dhe shërimi mjekësor, është e domosdoshme që nëndihmën sociale të përfshihen familjet e papunësuara dhe që kanë një fëmijë në shkollim të vazhdueshëm deri në moshën 18 vjeçarë. Në praktikë neni a nuk realizohet te ne, ndërsa neni b eliminon shumë skamnor nga ndihma sociale.

Propozoj që familja e varfér pa asnë anëtarë të punësuar me një fëmijë studentë të përfshihet nëndihmën sociale. Është e domosdoshme që një nga ligjet të hiqet tërësisht udhëzimet e ministrisë pasi që ligji është mbi të gjitha. Organi përkatës i qendrave për punë sociale paraqitjen e kërkesës për ndihmë sociale nuk duhet ta informojë brenda 45 ditësh që shkruan në Projektligj por në një afat më të shkurtër prej 30 ditësh sepse për skamorët një ditë është shumë e madhe. Me propozim ligj nuk është përcaktuar se cilat dokumente apo prova dëshmi duhet tia bashkangjes paraqitësi kërkesës. Përcaktimi i dënitit për realizimin jo objektiv ose të remë të ndihmës sociale është paraparë kthimi imjeteve por jo edhe procedura ligjore. Kjo duhet të përcaktohet me ligj e jo me udhëzimet e Ministrisë. Ankesa kundër organit të parë duhet bërë brenda 15 ditësh e jo 14 siç parashifet në nenin 10.

Në këtë propozim ligj duhet të përcaktohet edhe kompenzimi material për ata që presin punë më shumë se një vit.

Deputet të nderuar në emër të grupit parlamentar të LDK jep këtë sygjerim. E përgëzoj Ministrin e Mbrojtjes dhe Punës sociale për punën dhe kontributin e punës së saj në hartimin e këtij Projektligji dhe një herit me këto vërejtje dhe sygjerime i propozoj Kuvendit që ta miratoj në fazën e parë të shqyrtimit në parim. Ju faleminderit për vëmendje.

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENI**

Diskusuesi i fundit lutet Iljaz Pireva, dhe do të ishte mirë që deputetët të kenë parasysh që pas kësaj do të votojmë prandaj edhe të jemi në sallë.

### **MEVLUDE SARAÇI**

E nderuara Kryesi, të nderuar kolegë dhe deputetë dhe ju ministra, Projektligji për të cilin po e diskutojmë sot është më se i rëndësishëm për rrethanat çfarë janë sot në Kosovë.

E di që shumica prej deputetëve që jan lodh megjithatë është kulturë demokratike kjo të ndëgjohemi. Jemi dëshmitar se mijëra familje në Kosovë kanë arritur pikën kritike egzistenciale. Rregullorja me të cilën ka qenë e rregulluar kjo materije deri më tani as për së afërm i ka mbuluar nevojat të qytetarëve, fakti që Kosovës së pas luftës ju kan shtuar shumë familje nevojtare, përfaktin se janë vrarë burat apo djemtë në luftë e që kanë qenë mbajtës të familjes apo mungojnë anëtarët e aftë për punë e të cilët janë të zhdukur apo të kidnapuar me rregullore në fjalë shumica prej tyre nuk kanë mundur ta rregullojnë statusin e tyre si shfrytëzues të ndihmave sociale.

Jemi dëshmitar që pikërisht që shumica e familjeve që nuk i kanë plotësuar kriteret në bazë të rregullores e i kanë plotësuar e i plotësonë realisht kushtet për shfrytëzimin e kësaj ndihme e kanë ndier dhe e ndiejnë veten të fyter dhe të lanë anash nga shoqëria dhe institucionet e Kosovës, sidoqoftë ky projektligj me disa plotësime duket të jetë i përgaditur mirë dhe deri në një mas dhe të arrijë të zbus kërkeshat e nevojtarëve. Vërejtja ime është që nuk duhen të quhen të varfér a ta njerëz që kanë nevojë për këtë llojë ndihme, ngase më duket se është fjalë nënçmuese dhe fyese, por le të mbetet vetëm fjala nevojtarë, e them këtë se familjeve të tyre më shumë u duhet krenaria, faktin se ata kanë dhënë shumë për të arritur që Kosova ta ka lirinë, prandaj, edhe ndihma duhet tu ipet që në a të mënyrë që ata edhe përkundër problemeve sociale ta ndiejnë veten edhe më tutje krenarë.

Pastaj kam vërejtje nën 3.2, a thua të gjith fëmijët e familjeve që gjëzojnë ndihmat sociale duhet të mbesin me shkollë të mesme arsimore, edhe për këtë jemi dëshmitarë se edhe 4 vite të pas luftës shumica e fëmijëve të kësaj kategorie dhunshëm pajtohem me fatin e hidhur se në moshën 18 vjeçare mbaron shkollimi

i tyre pa i përmendur rastet e veçanta aty këtu që në një apo mënyrë tjetër u është mundësuar shkollimi.

Nëpër vizitat dhe takimet që ka bërë Komisioni parlamentar për të rrëmbyerit e tha z. Sanije se kemi hasur në kategori të njerëzve që vërtetë janë në gjendje të rëndë sociale, pa kurfarë burimi të të ardhurash dhe pa perspektiv të shkollimit të mëtutjeshëm të fëmijëve të tyre në veçanti të vajzave. Jam e bindur që me këtë projektligj nuk do të zgjidhet i tërë problemi social që e mundon popullatën e Kosovës por le të jetë si bazë për zbutjen e këtyre nevojave për deri sa Qeveria të përgatis edhe ligjet tjera siç u cekën më lartë si për familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës dhe të familjeve të tyre ligji mbi statusin e familjeve të të rrëmbyerëve dhe të humburve që është një numër shumë i madh dhe ligjet tjera që sanksionojnë saktësisht kategorit e familjeve në mënyrë institucionale, pra edhe unë si të tjerët mbështes të tjerët dhe besoj se përmes amandamenteve do të plotësohen disa mungesa që janë përfshirë dukshëm në këtë ligj duke përgëzuar ministrinë për punë dhe mirëqenie sociale në pregaditjen e këtij Projektligji. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENI**

Fjalën e ka deputeti Ilaz Pireva i cili heq dorë me kaq përfundon debati i paraqitur për projektligjin në shqyrtim sipas rregullores me që u shtruna shumë propozime po edhe aty këtu vërejtje etj. e ka mundësin nëse e shef të arsyeshme t'i drejtohet Kuvendit përsëri Ministri Ahmet Jusufi, por meqë thuhet që është paraqitur edhe një deputet, që nuk di pse nuk është emri i tij në listë me mirëkuptimin tjuaj t'i japim fjalën Hagji Zylfi Mergja.

### **ZYLFI MERGJA**

Zotri kryesues inderuar, kryesi e nderuar, zotri deputet, zotri ministra të nderuarë, Të gjithë që folët ishte me vend, krejt i pranoj, por një gjë nuk e folët dhe këtë që nuk e ka përfshirë ligji nuk idhnohem, ne jemi për ate, prandaj edhe duhet ta plotësojmë ligjin, psh. këta që marrin ndihmë sociale, edhe paguajnë rrymën, pse? e paguajnë bërllogun, pse? e paguajnë ujin, pse? ata marrin ndihmë sociale e këndeju ju marrin të hollat. E kur të vdesin ata, kush do t'i vorros? Këte me ligj nuk e kemi parapa e me ligj duhet ta parashohim që atyre që marrin ndihmë sociale, kur të vdesin t'u paguhen shpenzimet për varrim. Ju kisha lutur Ministrisë që këtë ta rregulloj me ligj. Faleminderit.

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENI,**

Meqenëse Ministri nuk e sheh të arsyeshme t'i drejtohet Kuvendit dhe meqë shqyrtimi është përbyllur, e hedhim në votim ligjin e propozuar:

Kush është për: ..... të gjithë  
 Kush është kundër..... asnje  
 A ka që abstenojnë.....asnje

**Votimi – Glasanje – Voted:**

**Për – Za – For .....** **Të gjithë – Svi – All**  
**Kundër – Protiv – Against.....00**  
**Abstenime – Uzdrzanih – Abstained..00**

Konstatoj se Kuvendi i aprovon njëzëri me 79 vota të pranishme e pa asnje kundërshtim dhe pa asnje abstenim, propozim ligjin për listën për ndihmën sociale. Ju faleminderit

*(Duartrokitje)*

Në radhë kemi pikën e pyetjeve. Sipas referimeve të zyrës për parashtresa dhe propozime në afatin e paraparë me rregullore është konfirmuar përgjegjja e Ministrit të punës dhe mirëqenis sociale z. Ahmet Isufi në pyetjen e deputetit Ismail Kurteshi, ndërkohë që nuk është konfirmuar përgjigjja gojore e kryeministrat pyetjes së deputetit të Ramadan Kelmendit lidhur me skemën e ndihmës sociale ; këtu nuk po e shoh të shkruar por ne morëm vesh paraprakisht se është konfirmuar po ashtu edhe përgjigjja me shkrim e ministrit të Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente z.Behxhet Brajshorit pyetjes së deputetit Ismail Kurteshit dhe me kaq përfundon shqyrtimi i pyetjeve të parashtruara.

Kalojmë në pikën e fundit të seancës së sotme,

- propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 12 qershori të vitit 2003.

Ndërkohë z.Bajrush Xhemajli kërkon fjalën për një çështje procedurale.

**Bajrush Xhemajli**

Të nderuar të pranishëm,

Ky Kuvend kohë më parë ka marrë vendim që Komisioni për Tregti dhe Industri të mbledh me gojë dhe më shkrim materiale të ndryshme, analiza, përgjendjen në Korporatën Energetike të Kosovës dhe mbi bazën e tyre të bëhet një

raport për të debatuar një ditë të seancës plenare, në mënyrë që nga kjo seancë të dalin rekomandime për të dalë nga kjo gjendje që vërtetë është tejet e rëndë.

Edhe pse ne si Komision pas një pune të gjatë dhe të mundimshme ka kohë që kemi kryer punën tonë dhe raporti i është dorzuar Kryesisë në Parlament por për çudi Kryesia nuk e ka marrë ende në shqyrtim dhe natyrisht rrjedhimisht nuk është në rend të ditës që është një befasi për ne, sepse mendojmë edhe ashtu që jemi vonuar pak. Ne si Komision po mendojmë që kemi shkuar në teren dhe kemi mbledhur materiale të shumta e tj. Ndoshta Kryesia është e ntuziazmuar se këto ditë ka rrymë, por parat e suficitit të Kosovës do të harxhohen shumë shpejt që janë ndarë me zemërgjerësi shumë të madhe të z.Shtajner.

z. Shtajner sigurisht do të shkojë së shpejti dhe ne do të mbetemi në terr edhe ashtu, prandaj jo në këtë formë siç është duke shkuar sigurisht që po, por ne së paku duhet ta kryejmë si parlament punën tonë ta qesim në rend të ditës me një seancë kush e di kur, por them sot një javë e ta kryejmë punën tonë me rekomandime, konkluza që do të mund të nxjerrim nga ky Kuvend, dhe gjithsesi do të doja që sot një javë të jetë në rend dite kjo çështje. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENI**

Dëshiroj t'ju informoj që erdhëm në përfundim me përfaqësuesit e sekretarisë se materiali i dorëzuar është marrë në shqyrtim, u është shpërndarë anëtarëve të Kryesisë dhe dje është futur në procedurë të rregullt që do të thot për shqyrtim në Kryesi. Supozoj që do të shqyrtohet në mbledhjet vijuese të saj, ka mirëkuptim edhe për vërejtjet edhe për angazhimin për një përshtypsim edhe të shqyrtimit të nismave që vijnë nga deputetët. Në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme është futur vetëm një pikë për arsyet, siç është thënë edhe në ftesë, nuk janë krijuar ende kushtet, besoj që do të krijojen kushtet për të; do të thot të kemi vetëm propozimin për shqyrtimin e çështjes së privatizimit sipas kërkesës të bërë me kohë të grupeve parlamentare të PDK dhe LDK të rishtuar tash vonë, kurse ka kërkuar fjalën edhe deputeti Ismail Kurteshi,

### **ISMAIL KURTESHI**

Deputet të nderuar, kryesi e nderuar, të nderuar ministra,  
Së pari ju dëshiroj ti falenderoj ministrat për përgjegjjet e tyre dhe çështja me përgjegjjet e ministrave zakonisht është në rregull, por sa i përket përgjegjjeve nga ana e Kuvendit dhe administratës së saj këtu ka ngecje të madhe. Unë me 9 prill të këtij viti e kam dorëzuar një mocion për të cilën nuk kam marrur asnjëherë përgjegjëje, kërkoj nga Kryesia ose nga Komisioni për Çështje Legjislativë por edhe nga administrata e Kuvendit që sa më parë të përgjigjet në këtë kërkesë, në pyetjen time me shkrim ose kërkesën time me shkrim po ashtu ka ndodhur shpesh që edhe në parqitjen ose në propozimin e pikave për rend të ditës si deputet ose si grup parlamentar të mos futen ato pika asnjë herë në rend të ditës dhe as të miren përgjigjeje, siç është rasti me propozimin e pikës për

funksionimin e Kuvendit për çështjen e decentralizimit dhe shumë pyetje të tjera, dëshiroj me këtë rast ta përmendi edhe një praktikë që po ndodhë shpesh në Kuvend.

Kryetari i Kuvendit ose këshilltari i tij shpeshë dalin në e mër të Kuvendit me qëndrime pa i shtruar ato çështje këtu, siç është çështja e Selanikut, prandaj kërkoj që kjo praktikë të ndërpritet, Ju falemnderit.

### **KRYESUESI HYDAJET HYSENI**

Ne po e shqyrtojmë rendin e ditës për mbledhjen e ardhshme, i mirëpresim edhe vërejtjet që bëhen për sçarimin tuaj mocione e kërkesa që janë në shqyrtim ose janë shqyrtuar personalisht nuk jam i kënaqur në mënyrën si janë proceduar dhe si janë trajtuar ato, dëshiroj tju përkujtoj që ne jemi të obliguar që të shqyrtojmë edhe kalendarin periodik të aktivitetit të Kuvendit dhe kjo do të ishte mënyra më e mirë që bashkarisht edhe të planifikojmë punën e Kuvendit, besoj se në këtë mënyrë do t'i kaloni vështësitë që dalin kësaj natyre, prandaj, a e konsiderojmë a pajtoheni me rendin e propozuar me propozimet që janë bërë ndërkohë, ka vetëm një pikë të rendit të ditës.

- Çështja e privatizimit,

Edhe ajo hipotetike për arsyet që i dini, kjo çështje do të shqyrtohet në mbledhjen e ardhëshme të Kryesisë ne do ti marim parasysh vërejtet dhe sygjerimet e juaja, mbledhjen e konsiderojmë të myllur, ju faleminderit për vëmendje.

*Seanca përfundoi në orën 13,50.*

*I-27+/rt*